

ANA LALAJ

DILEMA E ÇLIRIMIT

Dilema më se njëzetvjeçare për ditën e çlirimit të Shqipërisë në tryezën e historianëve. Ditëçlirimi si kohë historike dhe ditëçlirimi si simbol. Rikthimi i sotëm në çastet kur nazistët pushtues lëshuan Shkodrën, nevojë për përpikëri historiografike apo alibi për të rrëzuar simbolin? Komente mbi të dhëna të njohura dhe njoftime për të dhëna të panjohura.

Prej më se njëzet vitesh ditën e çlirimit të Shqipërisë nga pushtimi nazifashist dy kampet politike të vendit e përkujtojnë të ndarë nga njëri-tjetri. Të majtët festojnë më 29 nëntor, ndërsa të djathtët një ditë më parë, më 28. Për të majtët kjo është një ditë simbol, për të djathtët, megjithëse vlerësojnë pjesëmarrjen e shqiptarëve në luftë, 29 nëntori është dita e ripushtimit komunist dhe, për më tepër, festë kombëtare e ish-Jugosllavisë federative. Për ta do të ishte më e denjë që çlirimi i vendit të kujtohej në Ditën Kombëtare të Pavarësisë.

Këto janë ditët e fundit në pritje për t'u bërë 70 vjet që prej atij 28 apo 29 nëntori. Këto ditë vërehet se çdokush përpiqet të bëjë diçka dhe pakënaqësitë e shfaqura jo pak për programin e festimeve, për komisionet, për fondet e munguara financiare etj., duket se janë fashitur. Megjithatë as këtë herë nuk u kapërcyen mospajtimet për luftën, madje as u tentua. Data e çlirimit është njëra prej tyre. Ky përvjetor i rëndësishëm do të ishte një rast i mirë për t'i çuar palët drejt mirëkuptimit, edhe pse nuk jam e sigurt se cila do të kishte qenë rruga më e përshtatshme: një nismë e politikës, e strukturave akademike apo e Presidentit të Republikës, z. Bujar Nishani, i cili në këtë pikë është treguar më gjakftohtë dhe korrekt me protokollin e shtetit. Megjithatë ajo që merret me mend është se edhe kësaj here në ceremonitë përmbyllëse të dyja palët do të shkojnë të ndara.

E keqja është se edhe historianët ende nuk kanë ardhur në një mendje. Nëse për ta diferenca do ishte vetëm çështje e vlerësimit të fakteve, atëherë puna do të qe më e thjeshtë dhe subjektivizmat do të

zbuteshin. Nëse ndasia ka prapavijë politike, kjo do të thoshte ikje nga metodat shkencore të kërkimit dhe të vlerësimit. Në këtë rast studiuesit i duhet të bëjnë dy hapa shumë seriozë, por të domosdoshëm. Hapi i parë është të çlirohet prej ngarkesave politike, ashtu siç i duhet të kapërcejë një lloj ngurrimi, që të mban lidhur pas përfundimeve, të cilat mund të jenë arritur në një moment të caktuar dhe për një arsye të caktuar. Në asnjë shkencë, për më tepër në shkencat shoqërore, nuk mund të ketë përfundime fikse. Çdo e dhënë e re, në një fushë ose në një tjetër, shërben për të korigjuar ose përforcuar diçka. Hapi i dytë është kthimi në metodat e kërkimit dhe të vlerësimit shkencor, si mundësi e vetme për debat të frytshëm. Debatet që operojnë me mjete dhe kritere shkencore, vetëm ato sjellin produkte të qëndrueshme. Kjo ka vlerë edhe për temën në fjalë. Ky është një rast që tregon se mbeten ende shqetësuese pasionet me të cilat mbrohen ose hidhen poshtë gjërat, çka krijon ndjesi të keqe për nivelin e studimeve tona. Në këtë kuptim, ndoshta ia vlen ngasja për t'iu kthyer kësaj teme.

Diçka tjetër në këtë parashtrësë hyrëse. Mjaft prej atyre që kanë folur për ditën dhe datën e çlirimit, ndërhyrjet i kanë parë me të drejtë si ndërhyrje në simbol, mënyrën e ndërhyrjes e quajnë politike, ndërsa dilemën 28 apo 29 e shohin si kurth, ku janë tërhequr të gjithë, përfshirë edhe historianët. Kësisoj ata e mendojnë shterp çdo lloj diskutimi kur vjen puna për datën. Konstatimet janë me vend, ndërsa sugjerimi është i gabuar, sepse historianëve nuk mund t'u rekomandosh të mos merren me data, pasi ajo është puna e tyre. Për të qenë e sinqertë, edhe për mua kjo është nga ato temat që na ndodh rëndom t'i lëmë diku mënjane dhe nuk të bëhet t'i zësh me dorë. Kjo vjen për shkak të mënyrës si politika u është imponuar historianëve dhe si ne kemi krijuar me njëri-tjetrin llogore të pakuptimta. Megjithatë, nëse procesi është afektuar politikisht, braktisja e tij nuk është rruga më e mirë. Kështu, sillemi nga sillemi, vijmë prapë në çështje të metodës si t'i qasemi problemit dhe të shpëtojmë procesin.

Edhe një shpjegim të fundit. Lënda që kam në dorë dhe ndërtimi i kësaj trajtëse ma bën të detyrueshme më shumë se njëherë për t'i marrë dhe rimarrë të dhënat, pra për t'iu rikthyer fakteve. E di se kjo nuk është në të mirë të teknikës së të shkruarit, por shpresoj se lexuesi do ta tolerojë këtë pikë të dobët, nëse do t'ia arrijmë bashkërisht ta rindërtojmë një segment të ngushtë kohe, një rrjedhë ngjarjesh, e cila mbetet ende pjesë e debateve tona. Le të përiqemi.

Një historik i ditëfestës

Që prej 28 nëntorit 1944, kur Qeveria Demokratike e Përkohshme hyri në Tiranë, përgjatë një viti, nuk ka të dhëna zyrtare që provojnë se është folur dhe vendosur për ditën e çlirimit. Atë kohë për festat ka qenë në fuqi një ligj i vitit 1928. Në maj 1945, Kryesia e Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar i ka shtuar atij ligji katër festa të tjera, të katra kishin lidhje me luftën. E para ishte dita e kapitullimit të Gjermanisë naziste, 9 maji, e cila u shpall festë kombëtare. Festat e tjera: 16 shtatori, dita e Konferencës së Pezës, 10 korriku, dita e krijimit të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare dhe 24 maji, në përkujtim të Kongresit I Antifashist, i njohur si Kongresi i Përmetit.

Dita e çlirimit të vendit hyri në listën e gjatë të festave vetëm më 9 nëntor 1945. Në mbledhjen e Kryesisë së Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar të asaj dite është paraqitur një projektligj i plotë për festat zyrtare. Tërheq vëmendjen që në projekt përsëri nuk është vënë dita e çlirimit, ashtu siç nuk ishin vënë, fjala vjen, dita e 1 Majit ose dita e Novruzit, por që u shtuan në diskutime. Me sa duket, kjo mungesë e ka nxitur Bedri Spahiun, anëtar i Kryesisë, të shprehej si më poshtë: “Dita e 28 Nëntorit koincidoi me çlirimin e Shqipërisë, domethënë me rënien e Shkodrës, prandaj proponoj që emërtimi i festës së 28 Nëntorit të bëhet *Ditë e Indipendencës dhe e çlirimit të Shqipërisë*”.¹Në procesverbal shënohet vetëm “*nuk përkrahet*”. Bedri Spahiu ka këmbëngulur të hidhet në votë. Është votuar dhe ka marrë pesë vota, nga 23 gjithsej. Në këtë votim, së paku në dukje, nuk ka dorë Enver Hoxha. Më pas është vijuar me festat fetare dhe është bërë një pushim. Ky pushim, në mes të diskutimit të një projektligji, pa e përfunduar atë, të nxit për të menduar rreth arsyeve.

Sapo rifilloi mbledhja, e mori fjalën Ramadan Çitaku i cili, ndër të tjera, tha: “Dita e 28 Nëntorit 1912 është e drejtë të festohet, por dhe kjo e Luftës së Dytë, e Luftës së madhe duhet të shtohet [përkrahet]. Është vetëm çështja e datës. Me sa di unë, pas mesnatës së 28 Nëntorit 1944, armiku qe zhdukur nga e gjithë Shqipëria, domethënë dita e 29 Nëntorit u gdhi duke qenë Shqipëria e çliruar. Prandaj proponoj që dita 29 Nëntor të shtohet në ditët e festave kombëtare. Ne kemi vënë ditën e mbarimit të luftës së përbotshme e të mos vëmë ditën e çlirimit të Shqipërisë, më

¹Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë [më tej: AQSh], Fondi [më tej: F.] 889, viti [më tej: V.] 1945, dosja [më tej: D.] 108, fl. 37.

duket do të ishte gabim.”² Anëtarët e Kryesisë e përkrahën propozimin, me përjashtim të Gjergj Kokoshit, i cili e mendonte 9 majin një ditë feste të përbashkët me popujt e tjerë të çliruar. Bie në sy po ashtu që Enver Hoxha nuk ka folur fare, por kjo nuk do të thotë se për të ky diskutim ishte pa interes. Përkundrazi. Ka mundësi që deri atëherë ideja e një ditëfeste të veçantë për çlirimin ende nuk ishte e kristalizuar dhe Hoxha duhet të ketë qenë i papërgatitur kur u hap ky diskutim. Ndryshe nuk ka si shpjegohet që kjo festë, pavarësisht datës, nuk ishte vënë si e tillë në projekt. Më pas Hoxhës i është dashur të marrë një pushim për t’u këshilluar me shokët, së paku me disa prej tyre e veçanërisht me Çitakun, i cili është ai që do ta paraqesë dhe mbrojë versionin e tij të 29 Nëntorit. Që atëherë kjo ditë hyri në kalendarin e festave, duke u emërtuar si *e kremte zyrtare kombëtare*.

47 vjet pas dhe në vijim

Pas ndryshimeve demokratike në vend, rregullimi i parë për festat zyrtare u bë në dhjetor 1992. Kuvendi i Shqipërisë riktheu festat fetare që kishin qenë ndaluar për më shumë se 20 vjet, si dhe hoqi festat politike që lidheshin me sistemin e përmbysur. Ajo që ra në sy është se kur u publikua ligji, në listën e festave zyrtare mungonte dita e çlirimit të vendit nga pushtuesit nazifashistë.³ Megjithatë nuk ishte ky rasti që e solli debatin. Për çudi, aso kohe ndryshimi kaloi si pa u vënë re. Debatu hap një vit më vonë, në dhjetor 1993, kur dita e çlirimit u kthye në kalendarin e festave, por në një datë tjetër, më 28 nëntor. Ajo çka mund të shënohet është se atë kohë u vërejtën shenja revanshi kundër Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe nuk përjashtoj që ky të ishte refleksi i konflikteve të para 50 vjetëve. Duket se demokratët në pushtet vlerësuan se kjo nuk ishte në të mirë të klimës politike në vend, pa folur që Evropa vazhdonte të shfaqte respekt për simbolet e Luftës së Dytë Botërore. Ndoshta këto kanë qenë arsyet që demokratët e rikthyen ditën e çlirimit. Po ashtu, me të drejtë, ata u përpoqën t’i mëshonin idesë së kontributit jo të një partie të vetme, po të të gjithë shqiptarëve në krah të koalicionit antifashist. Megjithatë Lufta mbeti një kartë e fortë e socialistëve, të ardhur nga ish-partia komuniste dhe 29 Nëntori qe simbol

² *Po aty*, fl. 38-39.

³ Ligj nr.7651, datë 21.12.1992, “Për festat zyrtare”, në *Fletorja Zyrtare*, nr. 10, Kuvendi i Shqipërisë, Tiranë: 1992, f. 506.

i tyre. Prekja e ditës-simbol dhe zgjedhja e Ditës Kombëtare të Pavarësisë si strehë për ditën e çlirimit ishte një mënyrë për ta zbehur këtë të dytën.

Projekti për ndryshimin e datës së çlirimit u diskutua në Kuvendin e Shqipërisë më 22 nëntor 1993. Megjithëse kjo ishte një nismë e pastër politike, Sali Berisha, atë kohë president i vendit, u përpoq t'i jepte pamje tjetër. Ai ngarkoi më parë një grup historianësh të vlerësonin faktet historike dhe në bazë të tyre të saktësonin ditën, në të cilën forcat pushtuese u larguan nga Shqipëria. Atë kohë u fol nën zë se historianëve u qe kërkuar të sillnin fakte që flisnin në favor të 28 nëntorit, si dita e fundit e largimit të gjermanëve. Duket se kjo është e vërtetë, pasi një drejtues i Partisë Demokratike, vite më vonë, ka pohuar se më 1992 [në fakt më 1993] pushteti i partisë së tij “në vijim të përpjekjeve të drejta e të nevojshme të çmontimit të simbolikës së regjimit të vjetër, përcaktonte si datë të çlirimit 28 nëntorin”.⁴ Kjo do të thotë se nuk bëhej fjalë për vërtetësi faktesh, por për “përpjekje të nevojshme të çmontimit të simbolikës”. Sigurisht, udhëzimet mbetën rezervate, por gjithsesi mendoj se ato ndikuan për keq në prestigjin e komisionit, i cili në një farë mënyre u detyrua të dalë me një relacion të punuar nxitimthi. Relacioni ishte aq i dobët, sa opozita socialiste nuk e pati të vështirë ta atakonte atë jo vetëm politikisht, por edhe të gjente atje pasaktësi në të dhënat dhe fakte të njëanshme. Sidoqoftë, ndryshimi formalisht i propozuar nga një grup deputetësh fitoi shumicën e votave dhe neni i vetëm i Ligjit nr.7770, datë 22.11.1993 e përcaktonte 28 nëntorin si Ditë të Flamurit dhe të Çlirimit nga pushtuesit nazifashistë.⁵ E gjitha kjo ndodhi në prag të festave. Për herë të parë që prej vitit 1945, Protokollin i Shtetit hapi për homazhe varrezat e dëshmorëve jo më 29, po më 28 nëntor. Të njëjtën gjë bënë edhe zyrat e prefektit në qarqe. Por veteranët e Luftës, në shumicë, nuk e pranuan ndryshimin. Ata, si gjithmonë, vajtën të nderojnë shokët e tyre më 29 nëntor. Por atje ndodhi e papritura. Në mjaft prej qyteteve në portat e varrezave prisnin forca policie, që nuk lejuan të bëheshin nderime. Këtë ndërhyrje opinioni e komentoi si të tepruar, ndërsa opozita e përqasi me demonstratat antifashiste të 50 vjetëve më parë. Opozita, e cila vinte nga humbja e thellë e zgjedhjeve të marsit 1992, këtë rast e shfrytëzoi, veç të tjerash, edhe në plan elektoral.

⁴ Genc Pollo, “29 apo 28? Pse jo 17?”, gazeta *Panorama*, 30 nëntor 2003.

⁵ Ligj nr. 7770, datë 22.11.1993, “Për një ndryshim në Ligjin 7651, datë 21.12. 1992, “Për festat zyrtare”, në *Fletorja Zyrtare*, nr. 14, Kuvendi i Shqipërisë: Tiranë, 1993, f. 865.

Katër vjet më vonë, më 1997, opozita e sapoardhur në pushtet, e riktheu 29 nëntorin si ditë të çlirimit.⁶ Diskutimi për këtë qëllim u bë më 30 tetor të atij viti. Përgjithësisht, argumentet nuk ishin më historike. Ndërhyrjen e vitit 1993, socialistët e kishin konsideruar arbitrare dhe prandaj ata iu mbajtën versionit se po rivendosnin një akt që ishte ndryshuar arbitrarisht.⁷ Ndërhyrjen deri-diku e kishin konsideruar edhe të paligjshme, si ndërhyrje në të drejtën e organeve drejtuese të sapodala nga lufta për të marrë vendime të atij lloji, ku hynte edhe e drejta për të vendosur për ditën kur ishte çliruar vendi. Që prej asaj kohe dy grupimet më të mëdha në pushtet tri herë kanë këmbyer vendet, por data e çlirimit zyrtarisht nuk u ndryshua më. Megjithatë demokratët dhe socialistët e përkujtojnë atë të ndarë, duke iu mbajtur të dyja palët versioneve të veta.

Pak fjalë për kriterin e ditëfestës

Ditët përkujtimore për Luftën e Dytë Botërore në vende të ndryshme janë të ndryshme. Me sa di unë, disa prej vendeve të Evropës Lindore, deri në vitin 1990, kanë shënuar ditëçlirimin e kryeqyteteve si festa zyrtare. Pas këtij viti parlamentet e këtyre vendeve bënë ndryshime në festat e tyre, duke u reduktuar ditët përkujtimore të Luftës dhe u rivlerësuan ngjarje të tjera. Megjithatë në vende si Polonia, Republika Çeke, Slovakia, Serbia, Kroacia, Rusia 9 maji gjendet më shumë i përfshirë në listëfestat e këtyre vendeve. Por në të gjitha rastet, si para ashtu edhe pas vitit 1990, këto vende kanë përdorur kritere që i kanë menduar si më të përshtatshmet dhe mandej kanë vendosur për festat.

Po në rastin e Shqipërisë cili ka qenë kriteri, ku u vendos për Ditën e Çlirimit? Është e rëndësishme të vërejmë se dy herë që është folur dhe është vendosur për këtë çështje, edhe në Kryesinë e KANÇ më 9 nëntor 1945, edhe në Kuvendin e Shqipërisë, më 22 nëntor 1993, të dyja herët kriteri ka qenë i njëjtë. Kriter është marrë çlirimi i qytetit të fundit të Shqipërisë, në rastin tonë Shkodra. Më 1945, kur ka folur më së pari Bedri Spahiu që 28 nëntori të bëhet *Ditë e Indipendencës dhe e çlirimit të Shqipërisë*, ai ka sjellë për argument “rënien e Shkodrës”. Po atë rast,

⁶ Ligj nr. 8253, datë 30.10.1997, “Për një ndryshim në Ligjin 7651, datë 21.12. 1992 “Për festat zyrtare” ndryshuar me ligjet nr. 7770, datë 7.12.1993, nr. 7780, datë 22.12.1993 dhe nr. 8065, datë 8.2.1996”, në: *Fletorja Zyrtare*, nr. 16, Kuvendi i Shqipërisë: Tiranë 1997, f. 410.

⁷Legjislatura e 15-të e Kuvendit të Shqipërisë, seanca plenare e datës 30.10.1997, në *Punimet e Kuvendit* 1997, nr. 3, Kuvendi i Shqipërisë: Tiranë, 2001, f. 198.

edhe Ramadan Çitaku Shkodrën ka pasur parasysh kur ka thënë: “Me sa di unë, pas mesnatës së 28 nëntorit, armiku që zhdukur nga e gjitha Shqipëria...”. Më tej, kur e ka rimarrë fjalën, “duke treguar edhe njëherë historinë e çlirimit të Shkodrës më 29 nëntor”, ai ka këmbëngulur që kjo ditë “të pranohet si festë kombëtare”.⁸ Pra, të dy ata si kriter kishin të njëjtën referencë, por dy referenca kohore, i pari më 28 dhe i dyti më 29 nëntor. Herën e dytë, më 1993, komisioni që u ngrit me porosi të Presidentit të Republikës kishte për objekt pikërisht saktësimin e datës së çlirimit të qytetit të Shkodrës dhe relacioni që u paraqit nga ai komision merr përsipër të saktësojë të njëjtën gjë, çka do të thotë se kriteri nuk është prekur.

A mund të kishte një kriter tjetër për të caktuar datën e Çlirimit? Sigurisht që mund të kishte. Për shembull, mund të ishte çlirimi i Tiranës, kryeqyteti i vendit. Lufta për çlirimin e Tiranës ishte nga më të ashprat e më populloret dhe që zgjati njëzet ditë. Tërheqja e trupave gjermane nga Tirana praktikisht tregoi se lufta po shkonte drejt fundit. Mund të silleshin edhe argumente të tjera dhe nëse Kryesia e KANÇ do të kishte vendosur për bazë kriterin e çlirimit të kryeqytetit, vendimi nuk do të ishte i qortueshëm dhe ne sot nuk do të grindeshim. Por ja që nuk u mor ai kriter dhe vendimi ishte tjetër. Mund të ishte kriter hyrja e Qeverisë së Përkohshme në Tiranë, më 28 nëntor. Atë ditë në Tiranë filluan festimet, të cilat zgjatën tri ditë. Nuk kishte rast më të mirë për komunistët që Ditës së Flamurit t’i shtonin lavdinë e fitores së luftës së fundit, të cilën e kishin drejtuar ata vetë. Por nuk u mor as ky kriter, që do të ishte më se i arsyeshëm. U mor kriteri i “ushtarit të fundit në qytetin e fundit” dhe ne nuk kemi as mundësi dhe as të drejtë ta ndryshojmë këtë kriter.

Mendoj se kriteret, si në çdo gjë tjetër, janë thelbësore jo vetëm për vendimmarrjet, por edhe për ne që vlerësojmë vendimmarrjet. Për shembull, midis atyre që kanë shkruar për datën e çlirimit, ka prej tyre që e kanë sjellë shpesh për argument faktin që gjatë gjithë vitit 1945, në kuadër të përvjetorit të parë të çlirimit, njësitë e propagandës i janë referuar shpesh 28 nëntorit dhe përgatitjeve për 28 nëntorin, jo vetëm si Ditë e Flamurit, po edhe e Çlirimit. Kjo do të thotë se në ndjesinë popullore në këtë datë janë identifikuar dy ngjarje. Deri këtu dhe për aq sa u tha pohimi është i drejtë, por të mëtohet se kjo ndjesi përbën argument për ditëçlirimin, kjo është ikje nga kriteri mbi të cilën është

⁸AQSH, F. 889, V. 1945, D. 108.

bërë vendimmarrja. Kriteri i largimit të ushtarit të fundit nga qyteti i fundit nuk shkon me domosdo në pajtim me kriterin e hyrjes së qeverisë në Tiranë. Siç do ta shohim më tej, në rastin në fjalë, këto dy kritere nuk janë të përputhshme.

Kur analizojmë rastin, ia vlen të ritheksojmë se edhe komunistët më 1945, edhe demokratët më 1993, te kriteri mbetën të bashkuar. U ndanë te qëllimet, siç u ndanë kur erdhi puna të vlerësojnë faktet. Për qëllimet mund të vazhdojë të flasë politika e mund të komentojmë edhe ne të tjerët dhe sa për faktet, e mira do të ishte t'i vlerësonim të pandikuar nga politika. Njëzet vjet më parë u dëshmuua se kjo ishte e pamundur. Sot kohët po ndryshojnë dhe një vështrim retrospektiv mund të na ndihmojë për vlerësime të ftohta. Nëse jo rrallëherë faktorin shqiptar historia e ka ndarë, sot diçka mund të bëjmë që, së paku, vlerësimet për historinë të na bashkojnë.

Relacioni i përfolur i vitit 1993

Kur u thirr një komision me historianë etj., të cilët do të saktësonin ditën kur u çlirua qyteti i fundit i Shqipërisë, u pa që në krye se kjo ishte detyrë politike. Në fakt, në komision kishte edhe historianë seriozë, ashtu siç kishte veteranë të nderuar. Por kishte edhe politikanë aktivë, të cilët për momentin nuk i ndihmonin paanshmërisë së atij komisioni. Në këtë mënyrë vetë komisioni u kthye në komision politik dhe, sipas meje, e komprometoi qëllimin e shprehur për të saktësuar një datë historike. Por e gjitha kjo do të ishte e papërfillshme, nëse që andej nuk do të rridhnin të këqija të tjera. Që prej asaj kohe, për një datë në histori, përveçse u nda më dysh politika, u ndanë historianët, mësuesit, u ndanë madje edhe veteranët. U ndanë hartuesit e teksteve të historisë, duke iu servirur fëmijëve në shkolla dy data të ndryshme të çlirimit të vendit (!). E të tjera.

Sidoqoftë, le të kthehemi tek ai relacion me nr. 214 prot., datë 09.11.1993, "Për saktësimin e datës së çlirimit të Shkodrës" dhe që mban firmën e kryetarit të komisionit, Kasem Biçoku, aso kohe drejtor i Institutit të Historisë. Ky është dokumenti i parë që ne njohim, që merr përsipër të sjellë argumente historike, në nevojë të korrigjimit të një date "të gabuar" për njëherë nga ngjarjet e rëndësishme, për mua madhore, të historisë së shqiptarëve. Kohë më pas z. Biçoku shprehet se relacioni "që u hartua nga një komision i posaçëm specialistësh, u publikua dhe u botua së paku tri herë" dhe se "për argumentet e parashtruara në këtë

relacion nuk ka dalë ndonjë shkrim kritik që ta rrëzonte atë me të dhëna historike”.⁹ Kjo është pjesërisht e saktë, sepse herë pas here ky relacion është përmendur dhe ata që e kundërshtojnë versionin e 28 nëntorit, kanë kundërshtuar edhe argumentet e sjella atje. Të tjerë që i mbahen versionit të 28 nëntorit nuk janë marrë me relacionin, por janë përpjekur kohë pas kohe të sjellin argumente shtesë në mbështetje të tezës së tyre.

Kur bëhet fjalë për një raport historianësh, çfarëdo raporti qoftë ai, pra edhe ky që do të saktësonte çastet e fundit të luftës, do të duhej të plotësonte së paku dy kushte: a) të ishte koherent në faktet e mbledhura dhe b) të dhënat e sjella të ishin të mjaftueshme që të rrëzonin bindshëm të dhënat e mëparshme. Materiali në fjalë nuk e plotëson as njërin dhe as tjetrin kusht. Po e shpjegoj. Në relacion shkruhet: “*Më datë 27 nëntor 1944 në darkë gjermanët, në pamundësi për të marrë me vete armatimet e shumta të depozituara në periferi të Shkodrës, pranë Kështjellës së Rozafës, i hodhën ato në erë. Gjithashtu për arsye strategjike, shkatërruan dy ura lidhëse të rrethinave me qytetin. Ndërkohë gjermanët kishin minuar qytetin, gjë që kishte krijuar një psikozë frike e terrori në masën e banorëve të qytetit. Çminimi i tyre u bë nga dy italianë anonimë. Këto veprime i paraprinë largimit të formacioneve ushtarake gjermane nga qyteti i Shkodrës në drejtim të Hanit të Hotit. Largimi i tyre është bërë me mjete të motorizuara në paradreken e 28 nëntorit. Tricikli i fundit me ushtarë gjermanë është larguar në drekën e 28 nëntorit nga ndërtesa e ish-konsullatës italiane në Shkodër.*”¹⁰ Edhe një herë, sipas këtij materiali, depot e armatimeve si dhe dy urat lidhëse me qytetin [nënkupto urat e Bahçallëkut dhe të Bunës] janë hedhur në erë natën e 27 nëntorit. Po ashtu atë natë është bërë çminimi i qytetit nga dy italianë dhe të nesërmen paradreke formacionet ushtarake gjermane janë larguar nga Shkodra. *Tricikli i fundit është larguar në drekë, më 28 nëntor.* Përkundër përmbajtjes së këtij pasazhi, dokumentet, në shumicë, të dhënat gojore etj., shënojnë se episodet e shkatërrimit të municioneve dhe të urave nuk kanë ndodhur më 27 nëntor, por natën ose pasmesnatën e 28 nëntorit. Që do të thotë, më e pakta, se atë natë formacionet gjermane kanë qenë të

⁹ Kasem Biçoku, *Falangat që rrezikojnë kombin shqiptar*, Tiranë: Ilar, 1999, f. 218.

¹⁰ Relacion nr. 214, prot., datë 09.11.1993 i Institutit të Historisë drejtuar Kuvendit të Shqipërisë “Për saktësimin e datës së çlirimit të qytetit të Shkodrës”; shih edhe: *Studime historike*, nr. 3-4, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Instituti i Historisë: Tiranë: 1994; *Rilindja demokratike*, viti III i botimit, nr. 509, 13 nëntor 1993.

pranishme në Shkodër dhe për pasojë tricikli i fundit gjerman nuk është larguar në mesditën e asaj dite. Mospajtimet, inkoherenca brenda atij relacioni janë krejt të dukshme, ku tjetër gjë thonë dëshmitë e sjella për argumente e tjetër është përfundimi, sipas të cilit gjermanët e kanë lënë qytetin paraditen e 28 nëntorit.

Dy a tre shembuj. Në pikën 1 të relacionit, në mbështetje të datës 28, si ditë e çlirimit, komisioni sjell një trakt të Komitetit Qarkor të PKSHP për Shkodrën me titull “28 Nanduer”, trakt që komunistët e shpërndanë në Ditën e Pavarësisë. Trakti hapet me fjalët: “*Gjithë Shqipëria po e feston ditën e flamurit pa okupatorë e tradhtarë*”. Sipas komisionit, kjo fjali është dëshmia e parë dhe më kryesorja se më 28 nëntor Shqipëria ishte e çliruar. Nuk ka nevojë të jesh historian për të kuptuar frymën festive të një trakti që lëshohet në një rast të tillë dhe që e shpall si të kryer edhe atë që pritet të ndodhë nga ora në orë. Trakte si ky janë shpërndarë edhe në qytete te tjera të vendit. Fjala vjen, një trakt nga Elbasani i po asaj dite shkruan: “Asht e para herë që ne sot po festojmë një ditë lirie kaq fatbardhë për Atdheun t’onë.”¹¹ Kjo është krejt korrekte në frymë, sepse kjo “*ditë lirie*” tanimë vërtet kishte ardhur edhe në Tiranë, edhe në Elbasan, edhe në Shkodër. Por ky qytet i fundit ka një ndryshim të “vogël”, prandaj në traktin e atjeshëm shtohet edhe se “populli i jonë nuk do t’i uli armët derisa mos ta qërojë nga çdo *gjurmë nazisti barbar* [nënvizimi im-AL] e tradhtarësh...”, se “Shkodra kreshnike në këto çaste vendimtare ka për të dijtë me e diftue veten” etj.¹² Në këtë linjë arsyetimi, është vendi të shënojmë se këto trakte janë

¹¹ AQSHP, F. 249/Këshilli Nacionalçlirimtar i Qarkut Elbasan, L. 1, V. 1944, D. 15. Në arkivat e Shqipërisë ka mjaft trakte, mesazhe, të cilat janë shpërndarë më 28 nëntor 1944, në përvjetorin e Pavarësisë, në të cilët dëshmohet qartë se atë ditë Shqipëria ende nuk ishte çliruar. Këta dokumente u përkasin kryesisht strukturave drejtuese ushtarake dhe kur bëhet fjalë për veprime luftarake dokumentet dallojnë për gjuhën strikte. Kështu, më 28 nëntor, Shtabi i Korparmatës III shkruan: “*Pothuajse e gjithë Shqipëria është çliruar nga thundra e ndyrë e okupatorit ...*” [AQSHP, F. 212, L. 1, V. 1944, D. 14]. Kujtojmë se kjo Korparmatë u krijua më 18 nëntor 1944 dhe ishte formacioni kryesor që drejtoi luftimet në Shkodër. Po ashtu, më 28 nëntor, Brigada II shpërndan nga Korça një trakt të saj, ku thotë: “28 Nëntori e gjen sot *gati të gjithë Shqipërinë të lirë...*”. E njëjta gjë thuhet edhe në një mesazh tjetër të asaj dite, në njëvjetorin e krijimit të Brigadës: “28 Nëntori i sotshëm e gjen *gati të gjithë Shqipërinë të lirë*, të spastruar nga okupatori, nga dallaveraxhinjtë dhe reaksionarët e ndryshëm.” [AQSHP, F. 178, L. 1, V. 1944, D. 13].

¹² *Po aty*, F. 24/Komiteti Qarkor i PKSHP për Shkodrën, V. 1944, D. 10.

përgatitur për Festën e Pavarësisë dhe doemos që ato janë shpërndarë që në mëngjesin e asaj dite, përndryshe nuk kishte arsye të dilnin. Por, në qoftë se më 28 në mëngjes, kur ka dalë ky trakt komunist, Shkodra, si gjithë Shqipëria, ishte “*pa okupatorë dhe tradhtarë*”, atëherë ajo nuk është çliruar as më 28 dhe as më 29, po më parë, të paktën më 27 nëntor.(!) Edhe diçka tjetër, e thjeshtë fare.Çlirimi i një qyteti është një gjë që shihet. Në qoftë se ditën e 28 nëntorit Shkodra po e festonte “*pa okupatorë dhe tradhtarë*”, siç thuhet në traktin e Komitetit Qarkor të Partisë, atëherë pse një trakt tjetër, këtë herë i Këshillit Nacional-çlirimtar për Qarkun e Shkodrës, lëshuar po ashtu më 28 nëntor, thotë ndryshe? Trakti mban titullin “*Drejtë Çlirimit*” dhe aty shkruhet: “Populli i qarkut t’*onë, që asht në prakun e çlirimit të tij* [nënvizimi im-AL], nuk ka me e lejue që të hypin përsëri në fuqi njerzë që janë mësue gjithmonë me e shitë, që kanë pasë ndër xhepat e tyne njëqind flamuj...”¹³ Cili është i gabuar nga këto dy trakte? As njëri e as tjetri. I pari është i vërtetë në frymë, i dyti është i saktë në detaje. Për të shkuar më tej, po ky Këshill ka një trakt tjetër më 30 nëntor, ku njofton se Shkodra u çlirua. Vetë titulli “*Shkodra u çlirua*” dhe me nëntitull “*Në Shqipëri s’mbeti më këmbë okupatori dhe tradhtari*” tregon se ky është trakti i parë me këtë lajm që jep ky këshill dhe këtë e bën jo më 28, as më 29, po më 30 nëntor, që pasqyron një ngjarje të ndodhur dhe të përfunduar (thuaj po deshe të certifikuar nga organet e luftës) një ditë më parë. Dyshimi që dikush shfaq se ky dokument nuk është i besueshëm, pasi nuk është shkruar në dialektin shkodran, si traktet e deriatëhershme, po në toskërisht, mendoj se nuk ia vlen të komentohet.

Në vijim, si dëshmi të dytë, komisioni sjell shënimet e ish-komandantit të Batalionit I të Brigadës XXVII, Mehmet Terihati, në të cilat thuhet: “Dita 28 Nanduer ka qenë një ditë madhështore për partizanët e shumëvuajtur të Grupit të Shkodrës dhe për popullin shkodran, gjithashtu për krejt popullin shqiptar, masi në këtë mënyrë u lirua krejt Shqipëria.” Vetëm kaq është marrë nga shënimet e Terihatit “*Episode të luftës*”. [Saktësoj se Brigada XXVII është krijuar më 30 nëntor 1944 dhe batalioni për të cilin flet komandanti i saj atë moment ka qenë pjesë e Grupit të Shkodrës]. Por ky raport që është shkruar më vonë, në janar 1945, dëshmon më shumë se kaq. “*Episodet...*” flasin pikërisht për datën 28 nëntor, datë në të cilën, sipas shënimeve, ky batalion në

¹³ *Po aty*, F. 267/Këshilli Nacionalçlirimtar i Qarkut Shkodër, L. 1, V. 1944, D. 28.

bashkëpunim me Grupin e Shkodrës dhe me Brigadën XXII kanë zhvilluar luftime të ashpra diku në periferi të qytetit, në verilindje të tij. Në raport flitet për kompaninë II të atij batalioni, që arriti të zërë një pozicion në kodër, që quhej Kotrull i Madh dhe që e mbajti këtë pozicion për disa orë, derisa ra nata dhe armiku u tërhoq. Në pamje të parë duket se në këto shënime ka një lloj teprimi kur flitet për tentativat gjermane për të marrë kodrën, për kundërsulme partizane me këngë dhe granata dore dhe që goditjet me artileri të armikut ishin aq të forta sa partizanëve u “dolën jashtë përdorimit dy mitraloza të rëndë dhe një mitraloz i lehtë”. Është mjaft interesante se pikërisht këtë të dhënë të fundit e gjejmë në ditarin e majorit gjerman Behn*, i cili duket se është shef në postëkomandën e Korparmatës XXI malore. Majori Behn që prej datës 21 nëntor me efektivin e tij ishte vendosur në kanionet e lumit Morača (Mali i Zi), pak kilometra në veri të Podgoricës dhe që andej del se merrte rregullisht raporte nga Shkodra. Në shënimet e datës 28 nëntor flet për veprimet luftarake në periferi të Shkodrës dhe se humbjet gjermane, sipas ditarit, ishin “tre të vrarë, katër të plagosur” dhe se “për arsye të goditjes së fortë, armiku [partizanët-A.L.] humbi ose iu zhdukën dy mitraloza”.¹⁴ Këtë ditar do të kemi rast ta sjellim përsëri në vëmendje dhe këtë herë e përmenda thjesht për të konfirmuar përrputhjen rastësore midis shënimeve të oficerit gjerman me shënimet e komandantit shqiptar të batalionit për luftimet e datës 28 nëntor 1944. Në raportin e tij, komandant Terihatit më tej shkruan: “Po atë natë fillojmë të zbresim nga pozicionet malore në pozicione fushore. Në marrëveshje me Brigadën XXII përgatisim sulmin për brenda qytetit.”¹⁵ Ky është raporti i Mehmet Terihatit dhe këtë raport

* Në Arkivin Qendror të Shtetit ndodhet një ditar i majorit Behn, i përkthyer nga gjermanishtja në gjuhën shqipe. Varianti origjinal mungon. Po ashtu mungojnë edhe identitetet e tjera plotësuese të autorit të ditarit. Ky dokument mban referencën: *AQSH*, F. 41/Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacionalçlirimtare, V. 1944, D. 177, Ditar i majorit Behn, Korparmata XXI Malore.

¹⁴ *Po aty*, F. 41/Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacionalçlirimtare, V. 1944, D. 177, Ditar i majorit Behn, Korparmata XXI Malore.

¹⁵ *Po aty*, F. 199/Brigada XXVII e UNÇSH, V. 1944, D. 1; shih edhe: Sali Onuzi, *Data e çlirimit, 29 nëntor 1944*, Tiranë: Toena, 2005, f. 68-69. Për këtë moment flasin edhe shënimet e ish partizanit të Grupit partizan të Shkodrës, Bektash Sulo, të cilat megjithëse nuk kanë datë, duket se janë shkruar jo shumë kohë pas ngjarjeve. Në këto shënime thuhet se më 26 nëntor 1944, Grupi ishte në Rrjoll dhe aty komandanti Sadik Bekteshi kishte dhënë detyrën për të zbritur në fushë dhe për t’iu afruar Shkodrës. Atë natë partizanët u vendosën në fshatin Boks dhe më 27 në mëngjes sulmuan për të

komisioni e sjell për të provuar se më 28 paradite formacionet gjermane qenë larguar nga qyteti dhe se “për të siguruar tërheqjen pa dëmtime organizuan një manovër mashtruese pranë Urës së Mesit”. Por shënimet e Terihatit nuk flasin për një “manovër mashtruese”, përkundrazi, ato kanë qenë luftime që kanë zgjatur gjatë ditës e deri sa ka rënë nata, për të vazhduar më tej me një plan operacioni për rrethimin e qytetit.

Një dëshmi tjetër, pika 4 e relacionit është një buletin i luftës, me numër 56, i datës 5 dhjetor 1944, ku përshkruhen veprimet e Korpusit III. Nga buletini citohet: “Në kohën kur po kryhej nga forcat tona rrethimi i armikut që ndodhej në Shkodër, nazistët, duke përfitur nga nata dhe duke e parë veten në rrezik, u tërhoqën shpejt.”¹⁶ Sipas atij buletini, më 28 nëntor katër brigada kanë filluar veprimet për *rrethimin e armikut*.¹⁷ Është qesharake të mendohet se katër brigada fillojnë një operacion rrethimi të një qyteti të zbrazur! Por, siç thuhet në atë buletin, gjermanët kanë “përfitur nga nata” dhe janë tërhequr. Pra, edhe në këtë rast dokumenti flet për tërheqje të gjermanëve, vërtet më 28 nëntor, por *natën e asaj date* dhe jo paradreken apo në drekë. Me të tilla mospajtime është mbushur ai relacion që iu paraqit Kuvendit të Shqipërisë në tetor 1993 dhe mbi të dhënat e sjella atje u mor ai vendim politik që e ndryshoi datën e çlirimit të vendit. Një kritikë e zgjeruar për dhjetë pikat e atij relacioni gjendet në librin e Sali Onuzit “*Data e çlirimit, 29 nëntor 1944*”. Megjithëse libri ka një qasje të qartë politike, që e bën të paragjykueshëm që në krye, prapëseprapë aty nuk mungon një analizë e veprimeve ushtarake, që e veçon nga të gjitha botimet e tjera me këtë temë dhe ia vlen t’i referohesh. Si përfundim, relacioni që i shkoi Kuvendit ishte jo i mbështetur, me gjysma faktesh dhe me citime të njëanshme, që do të thotë i papranueshëm për nga kriteret shkencore dhe me pamjaftueshmëri argumentesh, të tilla që të përlligjin korrigjimet që u bënë aso kohe.

marrë kodrën e Kotrullit, e cila dominonte fshatin dhe mbahej nga gjermanët. U luftua gjithë ditën deri sa kodra u muar. Të nesërmen, më 28 nëntor, gjermanët erdhën përforcime, por Kotrulli nuk u lëshua nga partizanët. Atëherë “armiku i shpartalluem vihet në ikje dhe drejtohet për në qytet; në të nesërmen armiku kishte ikë edhe nga qyteti” [AQSH, F. 14/AP, V. 1944, Dosje në përpunim].

¹⁶Relacion nr. 214, prot., datë 09.11.1993 i Institutit të Historisë drejtuar Kuvendit të Shqipërisë “Për saktësimin e datës së çlirimit të qytetit të Shkodrës”.

¹⁷AQSH, F. 41/Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacionalçlirimtare, V. 1944, D. 160.

Më vonë, pas vitit 1993 e deri më sot, kjo temë është rimarrë herë pas here dhe argumenteve fillestare krejt të qortueshme, për të cilat sapo fola, u janë shtuar të reja, pro dhe kundër, dhe si të tilla ia vlen të trajtohen. Argumentet janë politike, juridike, të dhëna me karakter ushtarak, si dhe të dhëna të tjera, që i vijnë në ndihmë këtij ose atij grupi argumentesh. Në pamundësi për t'i marrë një e nga një, disa prej të dhënave mendoj se mund të trajtohen të grupuara.

Të dhëna që nuk përbëjnë argumente

Me aq sa u tha deri këtu, shpresoj të kem mirëkuptimin e lexuesit në dy pika. E para, mbajtja tek kriteri, sipas të cilit të gjitha shqyrtimet do të bëhen vetëm në raport me kohën kur është çliruar qyteti i fundit i Shqipërisë, prej nga është larguar njësia e fundit e ushtrisë pushtuese. Një kriter që, siç e kam thënë në mënyrë të përsëritur, u vendos nga organet e sapodala nga lufta dhe që është mbajtur i paprekur sot e kësaj dite, që do të thotë se te kriteri palët janë të bashkuara. Vijnë kështu tek pika e dytë, për të cilën po ashtu mendoj se kemi arritur një mirëkuptim. Fjala është për versionin se gjermanët u larguan nga Shkodra paraditen e 28 nëntorit, version që i është paraqitur Kuvendit të Shqipërisë më 1993. Jo vetëm mbrojtësit e 29 nëntorit, por edhe kundërshtarët e tij, në mjaft shkrime e kanë rrëzuar atë përfundim. Në gjendjen e tanishme të shqyrtimeve rreth kësaj teme, ata që mbrojnë 28 nëntorin, pranojnë se formacionet e fundit të ushtrisë gjermane kanë qenë të pranishme në Shkodër më 28 nëntor, në mbrëmje dhe se e kanë lënë qytetin po atë natë. Ajo që mbetet të ndajmë ose të saktësojmë është nëse këto formacione të fundit janë larguar para apo pas mesnatës së 28 nëntorit. Por më parë le të përjashtojmë nga shqyrtimi disa prej të dhënave që janë përdorur shpesh, por që nuk përbëjnë argumente dhe, për më tepër, nuk pajtohen me atë që e quajtmë kriter kohor të largimit të ushtarit të fundit nga qyteti i fundit i çliruar.

Cilat janë këto të dhëna? Ata që shkruajnë se Shqipëria u çlirua më 28 nëntor 1944 nuk janë të paktë, por më këmbëngulës janë studiuesit Kasem Biçoku dhe Vasfi Baruti. Në qoftë se *raporti Biçoku* që iu paraqit Kuvendit më 1993, sipas meje, ishte një dështim, duhet thënë se kërkimet e mëpastajme të këtyre dy autorëve sollën të dhëna që e vlejné të shqyrtohen. Më tej, nevoja do ta sjellë t'u referohem disa prej tyre. Por ndër to ka edhe mjaft të dhëna që na duhet t'i përjashtojmë. Një grup të dhënash e përbëjnë *dokumentet jo të verifikuara* dhe kësisoj ato duhen saktësuar. Shqyrtimi i dokumenteve në mënyrë kritike është alfa e çdo

kërkimi shkencor. Për shembull, për të provuar tezën se Shqipëria është çliruar më 28 nëntor, Kasem Biçoku sjell një urdhër të Enver Hoxhës të datës 22 nëntor 1944, dërguar Korparmatës III për ndjekjen e trupave gjermane në Jugosllavi. Urdhri thotë që pasi të ishte çliruar Shkodra, dy brigada të Divizionit VI do të marshonin në drejtimin Podgoricë-Danilovgrad, ndërsa Divizioni V në drejtimin e Mitrovicës, me detyrë të godisnin armikun dhe të merrnin kontakt me forcat jugosllave dhe me Ushtrinë e Kuqe.¹⁸ Urdhri është botuar në një përmbledhje dokumentesh më 1966, ribotuar më 1976 dhe autori Biçoku përdor një shënim të redaksisë, i njëjtë në të dy botimet, sipas të cilit “Divizioni VI (brigadat VI, VII, VIII dhe XXII) kaloi në Mal të Zi më 28 nëntor 1944 dhe në bashkëveprim me forcat e UNÇJ vazhdoi luftimet duke i ndjekur hitlerianët deri në Vishegrad”.¹⁹ Ky shënim i mjafton autorit për të konkluduar se pasi çliruan Shkodrën, më 28 nëntor, këto brigada po atë ditë kaluan në Mal të Zi.²⁰ Dr. Biçoku është studiues me përvojë dhe e kam të vështirë të besoj që ai të mos jetë ngacmuar të bëjë verifikimet e duhura rreth veprimeve të këtyre brigadave në fund të luftës, çast kur ato marrin një detyrë të re luftarake. Nga pohimet e gjithëpranuara del se këto brigada, shtu dhe brigadat XXIII dhe XXVII, me përjashtim të brigadave VI dhe VIII, më 29 nëntor ishin në festimet e asaj dite në qytetin e Shkodrës. Del se Brigada VI vërtet nuk hyri në Shkodër, por më 29 nëntor ajo është ndeshur me armë me praparojën e ushtrisë gjermane në Kopluk dhe më tej ajo ka marrë rrugën për në Zagorë, Rrapshë, Leqet e Hotit dhe e ka kaluar kufirin në lumin e Cemit më 30 nëntor, ora 09. 30 minuta.²¹ Del se Brigada VII është nisur nga Shkodra për në Kopluk më 30 nëntor dhe aty ajo është ndarë në dy pjesë, dhe po atë ditë dy batalione kanë kaluar kufirin për në Podgoricë dhe tre batalione kanë marrë detyrë për të kaluar në zonën e Dukagjinit.²² Brigada VIII nuk ka marrë pjesë në çlirimin e Shkodrës. Më 28 nëntor ajo ka qenë në parakalimin që është bërë në Tiranë dhe vetëm të nesërmen është nisur në drejtim të Shkodrës

¹⁸*Dokumente të Shtabit të Përgjithshëm e të Komandës së Përgjithshme të Ushtrisë Nacionalçirimitare Shqiptare*, vëll. II, 11 korrik 1944-10 korrik 1945, botim i dytë, Tiranë: 8 Nëntori, 1976, f. 325-326.

¹⁹*Po aty*, f. 325.

²⁰K. Biçoku, *Falangat që rrezikojnë...*, f. 222.

²¹AQSH, F. 182/Brigada VI e UNÇSH, Lista 1, V. 1944, D. 11; shih edhe: *Grushtçelik Brigad' e Gjashtë*, Tiranë: 8 Nëntori, 1973, f. 345.

²²AQSH, F. 183/Brigada VII e UNÇSH, Lista 1, V. 1944, D. 24.

dhe më tej jashtë kufirit shtetëror.²³ Po ashtu del se edhe Brigada XXII më 30 nëntor ka marrë detyrën për të kaluar kufirin në Han të Hotit, por pikërisht aty në kufi, në fshatin Bozhaj [Božaj], ajo është ndalur dhe është angazhuar në luftime në datat 3 dhe 4 dhjetor.²⁴

Në grupin e të *dhënave të paverifikuara* hyjnë shpesh edhe mjaft prej kujtimeve të veteranëve të luftës dhe sidomos ato që janë kumtuar shumë kohë pasi ka kaluar ngjarja. Sigurisht, ato nuk mund të përjashtohen apriori, por kur për të njëjtën gjë ekziston edhe dokumenti, në çdo rast dokumenti është parësor. Për shembull, për të njëjtin fakt ka dy pohime. Njëri është sjellë nga dr. Vasfi Baruti dhe që i referohet Shefqet Musarajt, i cili 30 vjet më vonë në kujtimet e veta paska shkruar se më 28 nëntor Enver Hoxha, në mes të fjalës së tij njofton lajmin e sapoardhur se “Shkodra, qyteti i fundit i pushtuar, u çlirua”.²⁵ Sigurisht, dr. Baruti, një qëmtues shumë i mirë dokumentesh, e di se ky komunikim nuk ka ndodhur as më 28 nëntor dhe as nga Hoxha, por më 29 nëntor nga Nako Spiru, në mitingun me të rinjtë e BRASH-it, pasditen e asaj date. Lajmi është dhënë në *Buletin i Luftës Nacionalçlirimtare* të datës 30 nëntor, nën okelion: “Ora e fundit. Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacionalçlirimtare njofton: Repartet e Ushtrisë Nacionalçlirimtare që veprojnë në veri të Shqipërisë çliruan Shkodrën”.²⁶ Ndërsa kronika e zgjeruar u botua më 1 dhjetor 1944.²⁷ Ky pohim i dytë është ai i sakti dhe nuk ka njeri që është ulur të hedhë dy fjalë në letër për ditën e çlirimit të mos e dijë këtë fakt. Pra, na duhet të jemi disi të rezervuar për vërtetësinë e kujtimeve në përgjithësi dhe sidomos në rastet kur ato kundërshtohen nga dokumente autentike dhe për këtë arsye na duhet t’i përjashtojmë nga ky shqyrtim.

Një grup i dytë të dhënash, megjithëse të sakta, ato janë *me natyrë agjitative, propagandistike* dhe si të tilla, sipas meje, po ashtu nuk përbëjnë argumente. Më duhet të them se në shkrimet për temën në fjalë, të dhëna të kësaj natyre janë sjellë vërtet me shumicë. Në një punim të tij, dr. Vasfi Baruti ka përmendur programin e festimeve nga 28 deri më 30 nëntor 1944 dhe në këtë program, në shkrime gazetash, në fjalime etj., del shumë qartë se në ndjesinë popullore “Dita 28 Nëntor ishte Ditë Lirie

²³*Po aty*, F. 184/Brigada VIII e UNÇSH, Lista 1, V. 1944, D. 8.

²⁴*Po aty*, F. 196/Brigada XXII e UNÇH, Lista 1, V. 1944, D. 7.

²⁵ Vasfi Baruti, “28 Nëntori i tretë”, *Studime historike*, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë: 2009, nr. 1-2, f. 368.

²⁶*Buletin i Luftës Nacionalçlirimtare*, viti I, nr.52, Tiranë, 30 nëntor 1944.

²⁷*Buletin i Luftës Nacionalçlirimtare*, viti I, nr.53, Tiranë, 1 dhjetor 1944.

dhe Pavarësie për popullin dhe kombin shqiptar”, se në program shprehet se “Festimet e Ditës së madhe të 28 Nëntorit që... sivjet koïncidon me festën e çlirimit të Tiranës dhe të gjithë Shqipërisë do të vazhdojë për tri ditë”.²⁸ Kjo ndjesi e ka çuar dr. Barutin në përfundimin se dita e çlirimit të Shqipërisë është pa ndonjë lidhje kushtëzuese me çlirimin e Shkodrës dhe se 28 nëntori 1944 është fakt historik, i pakundërshtueshëm, që i ka vënë vulën historike 28 Nëntorit, dita e Flamurit dhe e Çlirimit”.²⁹ Në vijim është edhe një konstatim tjetër që e kanë vërejtur edhe dr. Biçoku edhe dr. Baruti, po dhe të tjerë, të cilët i janë referuar fjalimit të Enver Hoxhës që mbajti më 28 nëntor në Tiranë ku, ndër të tjera, thotë: “Dita e flamurit u bë dita dy herë e shenjtë, dita e çlirimit dhe e bashkimit të popullit shqiptar”.³⁰ Studiuesit e mësipërm kanë vërejtur se 24 vjet më pas, kur fjala e Hoxhës u përfshi në serinë e veprave, fraza e mësipërme është ndryshuar si më poshtë: “Dita e Flamurit u bë dy herë e shenjtë, Dita e Pavarësisë dhe e bashkimit të popullit shqiptar.”³¹ Këtë ndryshim në togfjalëshin “dita e çlirimit dhe e bashkimit të popullit shqiptar” autorët me të drejtë e shohin si manipulim dhe se, sipas tyre, atë kohë edhe vetë Hoxha 28 nëntorin e konsideronte edhe ditë të çlirimit. Mundet. Megjithëse nuk duhet të harrojmë se po atë ditë ai lëshoi një Urdhër drejtuar Ushtrisë Nacionalçlirimtare me rastin e Festës Kombëtare të 28 Nëntorit, ku thoshte edhe: “Detyrat që keni përpara janë të mëdha, qyteti i Shkodrës ndodhet ende në duart e okupatorit, ne duhet ta çlirojmë dhe të mos lëmë asnjë gjerman të dalë i gjallë nga tokat tona, duhet t’i shfarosim.”³²

Sidoqoftë, me aq sa japin dokumentet, duket se njerëzit janë përfshirë nga ndjesia se lufta kishte marrë fund. Dhe kjo ndjesi nuk ishte vetëm më 28 nëntor 1944, por edhe më parë, të paktën qëkurse Tirana u mor në kontroll nga formacionet e UNÇ. Por atë kohë ende nuk kishte një akt zyrtar që ta kishte vendosur datën 28 nëntor si ditë çlirimi. Madje, për hir të së vërtetës, nuk kishte ende as edhe një akt certifikimi të çlirimit përfundimtar të vendit. Është kjo arsyeja që në fjalimin e vet Omer Nishani më 28 nëntor, ndryshe nga Hoxha, ai u largohet termave

²⁸ *Buletin i Luftës Nacionalçlirimtare*, viti I, nr.51, Tiranë, 28 nëntor 1944.

²⁹ Vasfi Baruti, “28 Nëntori i tretë ...”, f. 370.

³⁰ *Buletin i Luftës Nacionalçlirimtare*, viti I, nr.52, Tiranë, 30 nëntor 1944.

³¹ Enver Hoxha, *Vepra*, 2, Tiranë: Naim Frashëri, 1968, f. 426.

³² *Buletin i Luftës...*, 30 nëntor 1944; Shih edhe *Dokumente të Shtabit të Përgjithshëm* ..., f. 330.

propagandistikë dhe kësisoj thotë: “Lufta Nacionalçlirimtare u fitua dhe Shqipëria është në vëngjillin e çlirimit.”³³ Po kështu telegramet që iu dërguan qeverisë së Tiranës në Ditën e Pavarësisë e bënin këtë dallim. Gjenerali britanik Percy dërgoi mesazh me anë të Radio Londrës: “Pothuaj gjithë Shqipëria u lirua”. Nga Washingtoni, Sekretari i sapoemëruar i Departamentit të Shtetit, Eduard Stetinius: “Sot ... ata patriotë po sulen të plotësojnë çlirimin e Shqipërisë”. Të njëjtën gjë edhe Mery Northon në Komisionin e Punëve të Jashtme të Kongresit : “Shqiptarët çliruan nga thonjtë e armikut të përbashkët gati krejt Shqipërinë”.³⁴ Me fjalë të tjera, më 28 nëntor 1944 ende nuk e kemi një akt zyrtar të ditëçlirimit të Shqipërisë dhe çdo slogan për çlirimin e gjithë vendit duhet marrë vetëm në kuptimin agjitativ. Pos të tjerash kur në plan propagandistik flitej për Shqipërinë e lirë, qoftë dhe ditën e 28 nëntorit, Shkodra ende nuk ishte çliruar. Por, ashtu sikundër jemi marrë vesh, ky është kriteri për vendimmarrjen dhe prandaj çdo e dhënë jashtë këtij kriteri mbetet pa fuqi argumenti.

Natën, mesnatën apo pasmesnatën e 28 nëntorit?

Argumente pro dhe kundra

Duke qenë se mëngjesin e 28 nëntorit Shkodra ishte ende e pushtuar, u morëm vesh që për qëllimin e këtij punimi, të mos i shqyrtojmë si burime me vlerë dokumenti të gjitha deklaratimet festive, para apo gjatë asaj dite, ku flitej për Shqipëri “të lirë”, “pa pushtues” etj. Kemi vërejtur po ashtu se versioni sipas të cilit paraditen e 28 nëntorit Shkodra u zbraz tërësisht nga formacionet pushtuese është kundërshtuar në shumicë si i pasaktë. Kësisoj koha kur janë larguar trupat e fundit pushtuese është nata e 28 nëntorit. Këtë e thonë shumica e dokumenteve që ne kemi në dorë dhe që nuk janë të panjohura, e thonë edhe më të shumtët prej autorëve që janë marrë me këtë temë.

Ajo që mbetet të bëjmë dhe që po e tentoj edhe unë si të tjerët, është të shkojmë sa më afër kohës së saktë, kur ka ndodhur largimi i trupave pushtuese. Me që në këtë punim, unë jam përpjekur që shqyrtime t'i shoh edhe si çështje metode, më duhet të biem dakord edhe më tej që rendi i përparësisë së të dhënave të jetë ky: në krye dokumentet autentikë [urdhra dhe raporte luftarake, ditarë që janë mbajtur në kohën e ngjarjeve,

³³Buletin i Luftës ... 30 nëntor 1944.

³⁴Po aty.

kronika të ditës], më tej raportet e tjera, por më të vona në kohë dhe më në fund kujtimet e aktorëve të luftës dhe të dëshmitarëve të tjerë të ngjarjeve, por që janë regjistruar vite më vonë.

Cilido që është marrë me studimin e fundit të Luftës në Shqipëri, duhet të ketë vërejtur se në ditën e fundit të luftimeve në Shkodër kronikat shkojnë deri në një cak dhe aty ngecin. Kjo është mbrëmja e datës 28 nëntor. Pastaj duket se të dyja palët ndërluftuese tërhiqen në kampet e tyre për të pritur të nesërmen. Ndonjëri nga raportet thotë se shqiptarët kishin edhe një plan rrethimi të qytetit, që me sa duket do ta vinin në zbatim në të zbardhur të 29 nëntorit. Por atë natë ka ndodhur e papritura. Në mëngjes qyteti ishte i zbrazur. Pakkush di të thotë kur ndodhi saktësisht tërheqja dhe rrëfimet e atyre që japin siguri pothuajse na kanë munguar deri më tani. Kronikat shqiptare flasin se përplasjet zjarr me zjarr në mbrëmjen e 28 nëntorit kanë qenë kontakti i fundit midis forcave ndërluftuese. Ne nuk kemi në dorë kronikat gjermane, ku të jenë shënuar urdhrat përkatës, koha e saktë apo detaje të tjera për evakuimin e pjesës së mbetur të trupave gjermane në përbërje të Divizionit të Këmbëtorisë ID [Infanterie Division] 297, veprimet e preparojës etj. Ky boshllëk, sigurisht, na i vështirëson shqyrtimet objektive. Sidoqoftë, me gjithë mungesat në të dhëna, na duhet të shqyrtojmë argumentet që mbrojnë njërin ose tjetrin version.

Ata që mbrojnë versionin e tërheqjes gjermane më 28 nëntor

Midis atyre që këmbëngulin në versionin e zbrazjes së Shkodrës më 28 nëntor spikat dr. Vasfi Baruti, i cili sjell tri grupe të dhënash në mbështetje të pikëpamjes së vet. Një grup dhe më i rëndësishmi lidhet me kohën kur ka ndodhur tërheqja gjermane. I dyti lidhet me politikën që çoi në vendimmarrjen e vitit 1945, ndërsa i treti merret me anën ligjore të asaj vendimmarrjeje. Tani për tani po ndalem vetëm në disa prej të dhënave më kryesore të grupit të parë, të cilat janë:

1. Një kronikë e veprimeve luftarake të Brigadës VII, ku thuhet: “Më 28.11.1944, Brigada jonë në bashkëpunim me Brigadën 22, *sulmon qytetin e Shkodrës*. Armiku i tmerruar nga grushtet e shumta që pati marrë gjatë luftimeve, posa mori vesh që partizanët po i afroreshin

qytetit, *u larguan me shpejtësi*, pa mundur të bëjnë asnjë dëm. Në mëngjesin e datës 29.11.1944 Brigada VII hyri në Shkodër.”³⁵

2. Shënimet e komandantit të Batalionit I të Brigadës XXVII, Mehmet Terihati, në të cilat thuhet: “Dita 28 nanduer ka qenë një ditë madhështore për partizanët e shumëvuajtur të Grupit të Shkodrës dhe për popullin shkodran, gjithashtu për krejt popullin shqiptar, mbasi në këtë mënyrë u lirue krejt Shqipnia.”³⁶
3. Një ditar si më poshtë i zëvendëskomisarit të Brigadës XXIII, Sejdin Avdia: “27.11.44. Asgjë për t’u shënuar. 28.11.44. Sot informohemi se forcat armike janë larguar nga Beltoja dhe Bërdica, gjithashtu *janë pamun lëvizje tërheqjeje* [të gjermanëve] edhe nga Shkodra. Batalioni I i joni dhe Batalioni I i Brigadës XXIV marrin urdhën me sulmue Beltojen dhe Bërdicën, pra objektivat e mëparshëm. Në rast se këto objektiva do të arrihen me sukses, do të vazhdohet avancimi deri në Shkodër ... Janë *ndëgjue fjalimet* e mbajtura me rastin e festës [28 nëntorit] me anën e radios ... 29.11.44. Sot në mëngjes Batalioni I i Brigadës sonë *hyri në qytetin e Shkodrës*. Vendosi në Kalanë e Shkodrës flamurin.”³⁷
4. Buletini i Luftës Antifashiste i datës 5 dhjetor 1944, i cili përmban raportin me titull “Veprime të Korpusit të Tretë për çlirimin e Shkodrës”. Ndër të tjera, aty shkruhet: “Forcat partizane të Korpusit të Tretë dhe të Grupit të Shkodrës *ditën e 28 nëntorit* përgatiten për të sulmuar strehën e fundit të nazistëve dhe të tradhtarëve. Forcat e Brigadës VII kishin zënë pozicione në afërsitë e katundeve Gur i Zi, Renc, Bardhanjoll. Brigada XXII nga ana e Drishtit dhe Ura e Mesit, Brigadat XXIII dhe XXIV në afërsitë e Beltojës, Bërdicës dhe Ashtës.

Në kohën kur po kryhej nga forcat tona rrethimi i armikut që ndodhej në Shkodër, nazistët, *duke përfitur nga nata dhe duke e parë veten në rrezik, u tërhoqën shpejt*. Më 29 nëntor forcat e Korpusit të Tretë hynë në qytetin e Shkodrës të pritur nga i gjithë populli i qytetit...”³⁸

³⁵ AQSH, F. 183/Brigada VII e UNÇSH, Lista 1, D. 24, V. 1944; shih edhe: Relacion nr. 214, prot., datë 09.11.1993 ...; V. Baruti, “28 Nëntori i tretë...”, f. 371.

³⁶ Relacion nr. 214, prot., datë 09.11.1993 ...; V. Baruti, “28 Nëntori i tretë ...”, f. 371.

³⁷ AQSH, F. 197/Brigada XXIII e UNÇSH, V. 1944, L. 1, D. 15.

³⁸ V. Baruti, “28 Nëntori i tretë...”, f. 372.

5. Trakti i hedhur nga Komiteti Qarkor i PKSH për Shkodrën me titull “28 Nanduer”, që hapet me fjalët “Gjithë Shqipnia po e feston ditën e flamurit pa okupatorë e tradhtarë.”³⁹

Këto janë dokumentet më të rëndësishme të publikuara nga organet e shtypit të luftës ose kronika të afërta në kohë, ashtu siç ka edhe kujtime të cilat, sipas rastit, u mbahen ose njërit ose tjetrit version të evakuimit gjerman nga Shkodra. Të dhënat e përmendura më sipër, shtoj edhe ndonjë të dhënë tjetër të ngjashme, janë komentuar si argumente të pakundërshtueshme se Shkodra u zbraz nga gjermanët më 28 nëntor në mbrëmje. Mendoj se kjo është një gjuhë kategorike dhe, si e tillë, joprofesionale në komunikimet shkencore. Sepse dokumentet e cituara nuk shkojnë përtej dyshimeve dhe kësaj nuk i shërbejnë qëllimit pse janë sjellë. Për shembull, thuhet se gjermanët, sapo morën vesh që “partizanët po i afroreshin qytetit, *u larguan me shpejtësi*, pa mundur të bëjnë asnjë dëm”. [Pika 1 dhe 4 e të dhënave të cituara]. Pohimi “*u larguan me shpejtësi*” është marrë si një veprim që ka ndodhur në një segment të shkurtër kohe. Logjika e fjalisë vërtet është e tillë, por në kontekste dhe rrethana të caktuara fjalia “*u larguan me shpejtësi*” mund të shkojë nga disa minuta e deri disa orë, madje më shumë se aq, kur bëhet fjalë për operacione ushtarake. Po t’i kthehemi rastit konkret, në një situatë rrethimi që pritej të ndodhte gjatë natës, formacionet gjermane tanimë të reduktuara, nuk kishin epërsi taktike për të dalë nga rrethimi. Për këtë arsye ato janë detyruar të evakohen para kohe. Po kur? Informacionet e cituara thonë se kjo ka ndodhur gjatë natës, por jo se kur saktësisht. Si e tillë, kjo e dhënë nuk i ndihmon as njërit dhe as tjetrit version. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për shembujt e tjerë.

Tani një koment për këtë grup të dhënash. Bie në sy se qëkurse u rihap tema e ditës së çlirimit, mbështetësit e 28 nëntorit i zgjeruan mjaft kërkimet e tyre. Imtësitë e sjella nga dokumentet dhe kronikat e kohës u duk se e tronditën disi versionin tradicional të çlirimit më 29 nëntor. Megjithatë nuk është vështirë të vërehet se gjithë çfarë del prej këtyre hulumtimeve, siç u tha pak më lart, nuk janë tjetër veçse dyshime, të cilat sigurisht duhen vlerësuar, por vetëm si të tilla. Sepse dyshimet, edhe pse të çojnë tek e vërteta, ato nuk janë vetë e vërteta. Në shtjellimet e mëtejshme, do të kemi rast ta shohim edhe më mirë këtë dukuri, si dhe

³⁹AQSH, F. 24/Komiteti Qarkor i PKSH për Shkodrën, V. 1944, D. 10;shih edhe: Relacion nr. 214, prot., datë 09.11.1993... .

dukurinë tjetër si përdoren teknikat manipuluese kur operohet me gjysma faktesh ose kur tentohet siguri mbi të dhëna të pasigurta.

Ata që mbrojnë versionin e tërheqjes gjermane më 29 nëntor

Sipas historiografisë komuniste, natën e 28-29 nëntorit Shkodra u gjend nën sulmin e menjëhershëm dhe “nga të gjitha drejtimet” të formacioneve të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, por gjermanët përfituan nga errësira dhe i shpëtuan rrethimit. Më tej thuhet se atë natë “forcat partizane përparuan me shpejtësi në qendrën e qytetit”, se një batalion i Brigadës XXII goditi preparojën gjermane tek Ura e Mazharit, ndërsa “forcat e Brigadës XXIII u ngjiten në kalanë e Rozafës dhe asgjësuan armiqtë që gjendeshin aty”.⁴⁰ Këtë klishe tipike e gjejmë edhe në ndonjë studim të mëvonshëm, por gjithsesi në botimet e fundit akademike skema me operacione luftimesh të pandodhura janë shmangur. Në njërin prej këtyre botimeve shkruhet si më poshtë: “Luftime me forcat armike u zhvilluan përreth Shkodrës, në Postrisë, në kodrat e Drishtit dhe në të majtë të lumit Kir. Kundërsulmet që ndërmoren trupat gjermane, më 28 nëntor, u thyen me humbje të rënda. Pas mesit të natës forcat armike lëshuan qytetin. Në mëngjesin e datës 29 nëntor, në Shkodrën e lirë hynë luftëtarët e Ushtrisë Nacionalçlirimtare.”⁴¹ Gjithë sa është thënë më sipër, duket se është formuluar në mënyrë të përmbajtur dhe pak a shumë korrekte. Megjithatë do të kishim dashur që pohimi “*Pas mesit të natës forcat armike lëshuan qytetin*” të kishte qenë i mbështetur me të dhëna që e provojnë atë. Kësisoj, për qëllimet e këtij punimi, do të na duhet që këtë çast të përfolur ta mbajmë edhe më tej si tezë të debatueshme.

Sidoqoftë, mbështetësit e 29 nëntorit kanë edhe ata argumentet e tyre. Njëri prej argumenteve i përmendur më shpesh është lajmi për çlirimin e Shkodrës që Nako Spiru u dha të rinjve të Tiranës pasditen e 29 nëntorit, diku rreth orës 15: “Shokë, në këtë çast Shtabi i Përgjithshëm lajmëron se Ushtria jonë heroike çliroi Shkodrën. Shqipërinë tonë e kemi krejt të lirë!”⁴² Duket se Shtabi i Përgjithshëm, më parë se të njoftonte zyrtarisht çlirimin, ai ka mbyllur festimet e paradites në Shkodër, ka marrë në kontroll objektet publike dhe ushtarake në qytet, madje ka bërë

⁴⁰*Historia e Luftës Antifashiste të popullit shqiptar (1939-1944)*, vëllimi IV, Tiranë: 8 Nëntori, 1989, f. 856.

⁴¹*Historia e popullit shqiptar*, vëll. IV, *Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe pas saj (1939-1990)*, Tiranë: Toena, 2008, f. 102.

⁴²*Buletin i Luftës ...*, 1 dhjetor 1944.

edhe një varg arrestimesh midis atyre që u quajtën kolaboracionistë dhe që nuk mundën të largoheshin nga Shkodra dhe, më në fund, pasi ka marrë informacionin e duhur se rrugëkalimi Shkodër-Hani Hotit ishte i lirë, vetëm atëherë ka bërë me dije fundin e luftës. Në fakt, e mjaftueshme për të qenë ky çasti zyrtar i çlirimit të vendit! Por kundërshtarët e çlirimit më 29 nëntor thonë se në mëngjesin e kësaj dite formacionet partizane hynë në Shkodër pa luftë, pasi qyteti tanimë ishte i zbrazur. Pra, edhe ky dokument që thotë shumë, nuk na ndihmon në enigmën e largimit të ushtarëve të fundit që ne, me ose pa të drejtë, e kemi marrë për kriter.

Në kushtet e mungesës të një dokumentacioni shkoqitës të arkivave vendës, na duhet të përdorim të dhëna të tërthorta ose ato që i konsideruam si të nivelit të dytë, siç janë për shembull, kujtimet. Çfarë thonë ato? Ka një varg të dhënash se pasmesnatën e 28 nëntorit në qytetin e Shkodrës kishte prani ushtarake gjermane, nga të cilat le të veçojmë:

1. Hartuesit e kujtimeve për Brigadën VI kanë përfshirë edhe një shkrim që gazeta lokale e Shkodrës “Jehona” botonte në dhjetor 1944. Aty shkruhej: “Dhe mrekullia u ba, mbas gjashtë orë luftimesh të rrepta, partizanët e Grupit të Shkodrës, partizanët e Brigadës VI, arritën dhe e shpartalluen anmikun, i cili, i turpnuem e i vramë, si në të gjitha viset e tjera të Shqipnisë, ikën me bisht ndër shalë, por jo pa lanë gjurmët e barbarisë së tij. Pse mbas mesnatës së 28 nëntorit disa plasje të tmerrshme tronditën Shkodrën? Ishin urat e Bunës dhe të Bahçallëkut që u hodhën në erë nga vandalët e shekullit XX.”⁴³
2. Në librin e tij, “Në gjurmët e një ditari”, Ahmet Bushati përshkruan se në prag të mesnatës së 28 nëntorit qyteti u trondit prej shpërthimit të një sasive baruti dhe municionesh në lagjen Perash, më saktë në livadhin e Sulçe Begut. Më pas janë dëgjuar edhe tri shpërthime të tjera, kësaj here shkatërrimet e urave mbi Drin dhe Bunë. Sipas autorit, atë natë në qytet ishte kthyer një triçikël dhe pastaj kishin ndodhur shpërthimet. Bushati thotë po ashtu se rreth orës tre pas mesnate, kur triçikli po largohej, një kureshtar kishte dalë tek porta e shtëpisë, por ushtarët qenë kthyer dhe e kishin vrarë qytetarin Qamil Berberi, bashkë me të ëmën, duke u shënuar kështu viktimat e fundit të asaj nate.⁴⁴ Një version të ngjashëm sjell edhe At Zef Pllumi: “Atë

⁴³ *Grushtçelik Brigad' e Gjashtë...*, f. 334.

⁴⁴ Marrë nga S. Onuzi, *Data e çlirimit...*, f. 51.

natë u ndie zhurma e disa shpërthimeve të mëdha, aq sa u thyen xhamat e shumë shpijave. Nji motoçikël gjermane ishte kthye prej Hanit të Hotit për me i ndezë minat e vendosuna ndër urat që lidhshin qytetin me fushat.” Autori shpreh edhe qëndrimin e tij kur thotë: “Mbas atyne bumbullimave që shpallën largimin përfundimtar të gjermanëve [nënvizimi im-AL], nuk fjeti më kurrkush n’ atë natë të gjatë.”⁴⁵

3. Në rrjetet e informacionit elektronik është hedhur një shkrim i pesë vjetëve më parë i prof. Kristo Frashërit, ish-partizan i Brigadës XXIII, i cili na jep të dhëna interesante për ditët e fundit të luftës. Autori thotë se më 26 nëntor Brigada ishte vendosur në Bushat dhe se qenë bërë përpjekje për t’u marrë Kalaja e Bërdicës, e cila mbahej nga gjermanët, por pa sukses. Thotë po ashtu se më 28 nëntor në mbrëmje partizanët kishin festuar bashkë me fshatarët dhe se atë natë nuk pritej ndonjë aksion. Por “mbas mesnate, dëgjuam një tronditje të madhe që na zgjoi nga gjumi. Ishte ora dy e ca e mëngjesit e datës 29 nëntor 1944”⁴⁶. Rrëfimi vazhdon me përpjekjet e partizanëve për të kaluar Drinin, që ishte fryrë nga ujërat, me hyrjen e tyre në qytet, festimet etj. Në interes të kësaj trajtесе më duket pohimi se pas mesnate është dëgjuar një tronditje e madhe që i ka zgjuar të gjithë nga gjumi dhe pak më pas është vërejtur se “ishte ora dy e ca e mëngjesit”. Do ta kisha kaluar këtë detaj me mendimin se pohime të këtij lloji kanë me vete dhe një farë subjektivizmi, që as i provon dhe as i kundërshton dot, por që gjithëherë mbeten të dyshuara. Në rastin konkret pohimi i prof. Frashërit përputhet plotësisht me një raport zyrtar të kohës, me të cilin do të merrem më pas.

Çdonjëra prej të dhënave të mësipërme përmban të njëjtin fakt: se natën [sipas dikujt] ose pasmesnatën [sipas një tjetri] e 28 nëntorit janë shkatërruar dy ura të mëdha, pak kilometra pa hyrë në qytetin e Shkodrës. Po kështu kanë ndodhur edhe shpërthime brenda në qytet. Versioni se atë natë qenka kthyer një triçikël diku nga Kopluku apo më tej, nga Hani i Hotit, për të ndezur mbushjet me eksploziv në këmbët e urave, nuk duket shumë i besueshëm. Si veprim taktik nuk ka arsye për kaq shumë distancë midis kolonës në marshim dhe grupeve xheniere që do të

⁴⁵At Zef Pllumi, *Urno vetëm për me tregue*, Tiranë: Shtëpia Botuese 55, botim i dytë, 2006, f. 19.

⁴⁶Kristo Frashëri, “Ju rrëfej 29 nëntorin 1944”, tërhequr nga: [www. Shqipëria.com](http://www.Shqipëria.com).

shkatërronin urat dhe eksplozimet në qytet, pa folur se për grupet duhet të jenë marrë masa mbrojtjeje. Po kështu, qoftë dhe në kushte paniku, hedhja në erë e urave nuk mund të trajtohet as si harresë, gjë që për gjermanët ajo ishte një praktikë e mirëmenduar dhe që u përdor gjerësisht. Ajo që na intereson në episodet e kësaj nate është se pasmesnatën e 28 nëntorit në qytetin e Shkodrës kishte trupa pushtues dhe se shkatërrimi i urave është njëri prej episodeve. Veprime të këtij lloji dhe të këtyre përmasave çdo formacion ushtarak i shënon ndër aksionet e veta më të rëndësishme. Ajo çfarë nuk dimë janë hollësitë në këto veprime, si dhe sa vetë morën pjesë në minimin e këtyre objekteve, shkatërrimi i tyre, masat mbështetëse për grupin ose grupet xheniere, mënyra e tërheqjes etj. Por mungesa e informacionit për detajet as i shton dhe as i heq gjë faktit se njësi të trupave gjermane [sigurisht të reduktuara] ishin të pranishme në Shkodër, së paku deri pasmesnatën e 28 nëntorit.

Këto ishin të dhënat nga burimet shqiptare që kanë sjellë njëra ose tjetra palë. Duket se mbështetësit e 28 nëntorit nuk janë të sigurt me dëshmitë e tyre, prandaj ata janë mbajtur fort edhe në dy grupe të tjera argumentesh, të cilat janë politike, po ashtu edhe juridike. Duke qenë se ato janë artikulluar shpesh, është e nevojshme t'i shqyrtojmë këto grupe edhe si fakte, por edhe si interpretime.

Përkimi me festën e jugosllavëve

Argumenti më i përdorur pse Kryesia e Këshillit Nacionalçlirimtar caktoi 29 nëntorin si ditë të çlirimit është përkimi i kësaj date me festën kombëtare të ish-Jugosllavisë. Më 29 nëntor 1943, në Jajce të Bosnjës u mbajt mbledhja e dytë e Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar, thënë ndryshe mbledhja e AVNOJ-it [Antifašističko Vijeće Narodnog Oslobođenja Jugoslavije] dhe aty u vendos krijimi i Jugosllavisë federative. Dy vjet më vonë për jugosllavët kjo ditë u bë festa e tyre kombëtare. Kaq mjaftoi që të hidhej ideja se më 1945 në Tiranë ditëfesta ishte vendosur si pjesë e unifikimeve të pritshme me jugosllavët. Me sa di unë, i pari që e hodhi këtë tezë ishte Presidenti i vendit Sali Berisha. Në një mesazh që ai i drejtoi Kuvendit të Shqipërisë, më 13 nëntor 1993, shprehej se data 29 nëntor si ditë e çlirimit ishte caktuar me një djallëzi të madhe. “Ajo, shkruan Presidenti, është pjesë e platformës së bashkimit skllavërues të Shqipërisë me Federatën Jugosllave, premtim të cilin, me sa duket Enver Hoxha ia kishte dhënë Miladinit dhe Dušan-it, më 8

nëntor 1941... Jam i bindur se historia do ta vlerësojë këtë akt si komponent të tradhtisë së madhe kombëtare që udhëheqja e PKSH-së kishte gatuar që në themelimin e kësaj partie.”⁴⁷

Deklarata e Berishës ishte politike. Ajo u mbështet ose u kundërshtua, sipas rastit, nga njerëz të politikës, historianë etj. Ithtarëve të 28 nëntorit u duhej ta zhvillonin tezën e kreut të atëhershëm të shtetit, përkundër ithtarëve të 29 nëntorit, të cilët u detyruan të kthehen në mbrojtje. Përgjigja e atypëratyshme e të këtyre të dytëve ishte se 29 nëntori jugosllav nuk ishte ditë çlirimi, por ditë e federatës, e formës së regjimit, e ngjashme me 11 janarin 1946, kur Asambleja Kushtetuese e shpalli Shqipërinë republikë popullore. Por argumenti i tyre më i fortë ishte se shqiptarët kishin vendosur për festën e tyre të çlirimit më 9 nëntor, ndërsa jugosllavët kishin vendosur për festën e tyre të federatës njëzet ditë më vonë, më 29 nëntor 1945. Për të hyrë më në hollësi, vendimin për ditën e çlirimit në Tiranë e mori Kryesia e Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar, më parë se të mbaheshin zgjedhjet e 2 dhjetorit. Në Beograd vendimi për ditën kombëtare, një simbol që kishte të bënte me formën e regjimit dhe të organizimit federativ të shtetit, mund të merrej vetëm nga Asambleja Kushtetuese, e cila do të dilte pas zgjedhjeve. Më 11 nëntor 1945 u bënë zgjedhjet dhe Fronti Popullor fitoi shumicën absolute. Më 23 nëntor, në Byronë Politike të KQ të Partisë Komuniste Jugosllave, ndër të tjera, u vendos që seanca e parë e Kuvendit të shpallte ligjin për krijimin e Republikës Popullore Federative.⁴⁸ Kuvendi u mbajt më 29 nëntor 1945 dhe po atë ditë u shpall Republika Popullore Federative, duke vënë në stemën shtetërore “29 nëntor 1943”, siç kishim ne në simbolet e shtetit komunist shqiptar 24 majin 1944.

Argumenti se në Tiranë dita e çlirimit ishte caktuar më parë se të caktohej dita e federatës në Beograd, u duk se zuri vend. Por nuk vonoi që në shkrime të ndryshme të këmbëngulej se bëhej fjalë për një ujdi të kakohshme dhe të fshehtë me jugosllavët dhe mbi atë bazë Tirana ka vendosur për festat. Kështu problemi hyri në terrene hamendjesh dhe, siç

⁴⁷Mesazh i Presidentit të Republikës drejtuar Kuvendit Popullor, lidhur me festën zyrtare të ditës së çlirimit, *Rilindja demokratike*, viti III i botimit, nr. 509, Tiranë, 13 nëntor 1993.

⁴⁸*Politbyro Centralnog Komiteta Komunističke Partije Jugoslavije (1945-1948)*, Izvori za Istoriju Jugoslavije, Izdavački Arhiv Jugoslavije Službeni List SRJ, Beograd: 1995, st. 88.

ndodh në këto raste, nuk vonuan sajesa me emisarë, agjentë etj. Kësisoj, edhe pse ideja e një “marrëveshjeje” të hershme, që prej vitit 1941, nuk ka gjetur përkrahje, prapëseprapë mendimi se dita e çlirimit ishte vendosur duke bashkërenduar më parë me jugosllavët, kjo është një tezë e përhapur. Siç mund të kuptohet, argumentet në favor të kësaj teze janë krejt të varfra, për të mos thënë se mungojnë fare. Për shembull, është përmendur se Tito në telegramin e urimit më 28 nëntor 1944 për festën e pavarësisë, qenka shprehur se “tani edhe festat do t’i kemi të përbashkëta”. Kjo e dhënë është tjerre gjatë, por në nëntor 1944 kur festohej hyrja e qeverisë në Tiranë, në buletinet e luftës nuk ka ndonjë mesazh të Titos. Në fakt, historiani Owen Pearson, i cili ka një libër për Shqipërinë, citon agjencinë e lajmeve Tanjug përmes të cilës më 29 nëntor Tito i ka dërguar një mesazh Këshillit të Përgjithshëm të Frontit Nacionalçlirimtar të Shqipërisë. “Duke shprehur përgëzimet e tij për shqiptarët, me rastin e ditës së tyre të çlirimit kombëtar, Marshalli Tito deklaroi se *festa shqiptare do të jetë po ashtu festë për popullin e tij [nënvizimi im-AL], sepse Shqipëria dhe Jugosllavia “kanë qenë gjithnjë të lidhur me atë që është forcuar edhe më shumë gjatë luftës për çlirim: dëshirën e madhe për liri dhe pavarësi kombëtare, që nuk njeh asnjë pengesë”*.⁴⁹ Në këtë mesazh që duhet të ketë mbërritur vonë në Tiranë flitet për festë, jo në kuptimin e një date të caktuar, sepse atëherë nuk kishte një datë të tillë, por për një akt të kryer, siç ishte çlirimi i vendit. Më kryesorja ai nuk flet për festa zyrtarisht të përbashkëta, po për festën shqiptare që do të ishte edhe festë e popullit të tij. Në tri vitet që pasojnë mesazhet e Titos kanë qenë drejtuar gjithnjë me rastin e 28 nëntorit dhe asnjëherë për 29 nëntorin. Ky fakt bën të besosh se Josip B. Tito nuk kishte ndonjë afeksion të veçantë për ditën tonë të çlirimit, qoftë dhe duke e përqsaur atë me Ditën Kombëtare të Pavarësisë dhe jo më pastaj të jetë sikletosur si e si ta bashkonte me festën kombëtare të vendit të vet! Dhe për këtë arsye mesazhet e tij për Hoxhën nuk e kapërcenin terminologjinë standarde me “urimet e përzemërta me rastin e festës kombëtare të Shqipërisë – 28 Nëntorit, Ditës së pavarësisë së Shqipërisë, Ditës së flamurit kombëtar”.⁵⁰ Kështu, vit pas viti.

⁴⁹ Owen Pearson, *Albania in the Twentieth Century: A History, Volume 2, Albania in Occupation and War, From Fascism to Communism, 1940-1945*, The Centre for Albanian Studies, in association with I. B. Tauris, London: 2005, p. 414.

⁵⁰ AQSH, F. 14/AP-MPKJ, V. 1945, D. 3.

Në fakt, togfjalëshi “festa të përbashkëta” është përmendur, por asnjëherë nga Tito dhe as në kontekste të ndonjë marrëveshjeje të mundshme politike. Për shembull, këtë togfjalësh e ka përdorur Ramadan Çitaku, më 29 nëntor 1945 në një miting në Prizren, në ditën e mbledhjes së parë të Asamblesë Kushtetuese dhe në dyvjetorin e mbledhjes së AVNOJ-it. Në atë miting Çitaku u shpreh: “Due t’ju them edhe një gjë. Kjo asht festa e përbashkët e jona, se edhe populli shqiptar ka luftue krah për krah me popujt e Jugosllavisë e me Aleatët tonë të mëdhenj, Bashkimin Sovjetik, Anglinë dhe Amerikën.”⁵¹ Më tej e gjejmë edhe në raste të tjera, fjala vjen në një mesazh urimi të Enver Hoxhës drejtuar Titos, më 1946, ku i thotë se “sot në këtë ditë feste të përbashkët populli shqiptar brohoret për miqësinë, për vëllazërimin dhe aleancën tonë të pathyeshme...”. Me fraza të këtij lloji ishte mbushur shtypi i shkruar, radio etj. Por kjo është gjuha politike e propagandës së kohës dhe kurrësi nuk shërben si argument në favor të një marrëveshjeje pararendëse për “festat e përbashkëta”.

Ka dhe një arsye tjetër që përjashton ujdite e këtij lloji dhe që e ka shpjeguar mjaft mirë Sali Onuzi në librin e tij. Shpjegimi pak a shumë është ky: nëse do të kishte një porosi të Titos për një ditë feste të përbashkët, atëherë në një farë mënyrë kjo do të kishte lënë gjurmë, me gjithë dëshirën dhe përpjekjet për t’u mbajtur e fshehtë. Për shembull, do të qe marrë një vendim kur janë trajtuar dy herë ditët përkujtimore të luftës, një herë më 9 maj dhe herën e dytë më 22 maj 1945. Aty është vendosur për data të tjera përkujtimore, por jo për çlirimin e vendit. Nëse do të kishte një ujdë, do të gjendej një mënyrë e denjë për t’u zbatuar. Marrim rastin se kjo është kërkuar më vonë, domethënë pas majit. Nëse do të ishte i vërtetë ky variant, atëherë, më e pakta, propozimi do të ishte përfshirë në projektligjin që u paraqit më 9 nëntor dhe do të shmangeshin improvizimet e atypëratyshme. Shkurt, kemi të drejtë të mendojmë se gjithë kjo intrigë është ngritur mbi hamendje dhe sajesa, çka tregon sa e pafrytshme është dhe si krijohen pështjellime kur subjekte të mirëfillta trajtimesh në historiografi përthyhen sipas orientimeve politike ose shkojnë në pajtim me këto orientime.

⁵¹Gazeta *Rilindja*, Viti I i botimit, nr. 20, 11 dhjetor 1945, “Në mitingun e 29 nanduerit në Prizren foli ministri z. R. Çitaku”.

Ditëfesta si problem juridik

Një vendimmarrje si kjo për ditën e çlirimit sigurisht që është politike, por po aq është edhe juridike. Është juridike në të drejtën e organeve që marrin vendime si këto, në argumente, në procedura etj. Askush prej atyre që janë marrë me këtë temë nuk e ka vënë në dyshim të drejtën e Kryesisë së Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar për të vendosur për ditën e çlirimit të vendit. Mendimet pro dhe kundër ndahen pikërisht për procedurat. Një teze që i është mëshuar shumë nga ndonjë autor është ajo se, sipas tij, vetë Kryesia e Këshillit më 5 nëntor 1945 kishte marrë një vendim që e caktonte ditën e çlirimit më 28 nëntor dhe katër ditë më pas, pa rrëzuar vendimin e mëparshëm, po kjo Kryesi mori një vendim tjetër, këtë herë për datën 29 nëntor.

E thënë si më sipër, duket se kemi të bëjmë me thyerje flagrante të procedurave e, për pasojë, me falsifikim të pastër juridik. Po cila është e vërteta? Ajo që ka ndodhur është e thjeshtë. Ministri i Drejtësisë Manol Konomi i ka paraqitur Kryesisë së KANÇ-it projektligjin “*Mbi amnisti dhe falje për fajet ordinere të kryera deri në çlirimin e Shqipërisë*”, i cili është marrë në shqyrtim më 5 nëntor 1945. Duke qenë se në njërin nga nenet, neni 1, duhej shprehur për efektin kohor, domethënë për datën deri në të cilën amnistohen fajet dhe natyra e këtyre fajeve ordinere, në projekt është vënë data 17 nëntor, por të tjerë mendojnë për datën 28 dhe kjo e dyta u pranua nga të gjithë. Ky përfundim u fiksua në Ligjin nr. 134, datë 5.11.1945.⁵² Kjo është e gjitha. Studiuesi Vasfi Baruti, i cili është marrë posaçërisht me këtë moment, e ka sjellë në mënyrë korrekte aq sa është folur atë ditë për atë projektligj. Por, sipas meje, interpretimet e tij janë krejt pa vend. Ai thotë se “sanksionimi me ligj (neni 1) i 28 nëntorit, dita e çlirimit janë *argumenti ligjor* për 28 Nëntorin e Çlirimit të Shqipërisë”. Dhe më tej, “përderisa nuk ka asnjë ridiskutim të Ligjit të diskutuar dhe të vendosur me unanimitet për 28 Nëntorin, dita e Çlirimit të Shqipërisë, atëherë edhe sot, mbetet në fuqi Ligji i Mbledhjes së Kryesisë së Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar i 5 nëntorit 1945.”⁵³ I njëjti autor, në një shkrim tjetër, versionit të vet i jep “mbështetje” kushtetuese tek citon nenin 178, pika 1, të Kushtetutës, sipas të cilës “Ligjet dhe aktet e tjera normative të miratuara para datës së hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute do të zbatohen derisa nuk janë shfuqizuar”. Për

⁵² *Gazeta Zyrtare*, Viti II, nr. 71, Tiranë, 13 nëntor 1945.

⁵³ V. Baruti, “28 Nëntori i tretë...”, f. 380.

këtë arsye, sipas autorit, përderisa Ligji nr.134, datë 5.11.1945, nuk është shfuqizuar, ashtu si e kërkon Kushtetuta, atëherë ai është në fuqi.⁵⁴

Nuk e di arsyen pse një hulumtues pasionant si z. Baruti të shkasë në interpretime të gabuara, kur është fjala edhe për koncepte të thjeshta. Çdokush që merret me punë intelektuale di t'i dallojë objektin e një ligji dhe të një ligji tjetër, ashtu siç e di se këto dy objekte nuk mund t'i përziësh me njëri-tjetrin. Është e vërtetë, më 5 nëntor ligjvënësi ka diskutuar cili do të ishte kufiri kohor që njerëzit do të përfitonin nga veprimi i ligjit për amnistinë. Me atë rast ministri i drejtësisë kishte propozuar 17 nëntorin 1944 si datë kufi. Të tjerë e çuan më 28 nëntor, si dita e fundit e luftës, madje me arsyetimin se mund të kishte ndonjë përfitues më shumë. Kjo i ka mjaftuar z. Baruti të këmbëngulë me forcë se fuqi ligjore për ditën e çlirimit ka pikërisht ligji i 5 nëntorit. Mirëpo objekti i ligjit të 5 nëntorit nuk është data e çlirimit, më saktë nuk janë të kremtet zyrtare, por *amnistia për fajet ordinere deri në çlirimin e Shqipërisë*. Pra nuk është se më 5 nëntor u miratua ligji për festat zyrtare dhe më 9 nëntor u ndryshua, pa shfuqizuar ligjin e mëparshëm. Në qoftë se më 5 nëntor u fol vërtet për datën e çlirimit, në plan historik studiuesi këtë duhet ta shënojë. Ndërsa në plan juridik çështja shihet vetëm në kuptimin e ligjit për amnistinë, si nevojë juridike për të vënë një datë kufi. Vetë neni nuk lë shteg për interpretime. Ai thotë: "*Amnistohen të gjitha fajet ordinere të kryera deri edhe ditën 28 nëntor 1944, për të cilat ligja parasheh një ndëshkim me burgim...*"⁵⁵ dhe nuk ka, as mund të kishte përcaktim të kësaj dite si ditë e çlirimit të Shqipërisë. Rasti e ka sjellë të ketë projekt tjetër dhe diskutim tjetër enkas për festat zyrtare. Ky është 9 nëntori. Në këtë datë është diskutuar çështja e 28 nëntorit si ditë e pavarësisë dhe e çlirimit, propozim që nuk ka fituar. Është diskutuar 29 nëntori dhe ka fituar. Neni 6 i Ligjit nr. 155, datë 9.11.1945, e ka shfuqizuar dekretligjën e 6 nëntorit 1928 "*mbi ditët e pushimit të zyrave*"

⁵⁴ Vasfi Baruti, "Zbulohet Ligji 134, datë 5.11.1945: 28 nëntori është dita e çlirimit të Shqipërisë", *Gazeta Tema*, 11 tetor 2007.

⁵⁵ *AQSH*, F. 489, V. 1945, D. 108. Në botimin që është bërë në Fletore Zyrtare, nr.71, datë 13 nëntor 1945, data 28 korrigjohet duke u bërë 29 [nëntor]. Kjo ka ndodhur për shkak se Kryesia e KANÇ në ndërkohë [gjatë harkut kohor nga 5 nëntori kur është marrë vendimi deri më 13 nëntor kur është botuar kjo Fletore], kishte vendosur për ditët e festave dhe midis tyre edhe për datën e çlirimit. Kjo duhet të jetë arsyeja e kësaj ndërhyrjeje, për të cilën autorja e këtij shkrimi mendon se është jokorrekte, por që gjithsesi nuk ka të bëjë me thelbin e ligjit.

duke u shprehur edhe se “*çdo dispozitë në kundërshtim me këtë ligjë mbetet pa fuqi*”.⁵⁶

Anën juridike të këtij problemi më mirë nga të gjithë e ka sqaruar Spartak Ngjela, i cili në vendimin e nëntorit 1993 sheh një kapërcim konceptual të Kuvendit dhe për këtë shkak, sipas tij, Kuvendi ishte i destinuar të vuante mëkatën primar, pasi kishte gabuar njëherë. “Asnjë parlament në botë, thotë ai, nuk këqyr dokumentet historike, datat e caktuara janë kompetencë e gjykatave ... Datën e kanë caktuar ata të cilët kanë pasur në dorë të verifikonin në çfarë momenti e mbaruan luftën.”⁵⁷ Me të drejtë, Ngjela nënvizon të drejtën e Kuvendit vetëm të përcaktojë nëse do ta mbante ose jo ditën e çlirimit festë zyrtare, por jo kohën kur ka ndodhur momenti i çlirimit.

Duke përfunduar, mendimi se organet ligjvënëse të pasluftës kishin vendosur dy herë për të njëjtin objekt dhe vendimi i dytë ishte marrë pa u hedhur poshtë vendimi i mëparshëm, u kundërshtua si i pambështetur juridikisht, pasi nuk kemi të bëjmë me të njëjtin ligj, por me dy ligje të ndryshme dhe që po ashtu kanë për objekt rregullimi çështje të ndryshme. Aspekti i dytë i procedurave ligjore, për jokompetencën e një parlamenti të ndryshojë datat historike, kjo është çështje e pastër juridike dhe jashtë shqyrtimit të kësaj teme. E rëndësishme është se cilatdo qofshin të drejtat e një parlamenti, shqyrtimi në pikëpamje historike i kohëndodhjeve të një ose disa ngjarjeve, kjo mbetet një e drejtë e paprekur për historianin.

Me apo pa luftë?

Një pikë tjetër që lidhet me dilemën 28 apo 29 nëntor janë rrethanat si u çlirua apo u lirua Shkodra. Mendimi se ajo u lëshua pa luftë nuk është i saktë. Një segment i ngushtë kohe, në fakt i pandriçuar, para dhe pas mesnatës së 28 nëntorit, nuk është ky përcaktuesi për gjithë sa ka ngjarë në Shkodër. Megjithatë veçoritë e luftës në këtë qytet dhe përreth tij, ndoshta na ndihmojnë disi për të kuptuar edhe ato pak orë mbi të cilat është hedhur një hije misteri.

Shkodra është nga nyjat më tipike që e dëshmon rrokullimën gjermane në vjeshtën e vitit 1944. Për t’i shpëtuar asgjësimit, kryekomandanti i Frontit të Juglindjes dhe komandant i Gruparmatës E,

⁵⁶AQSH, F. 489, V. 1945, D. 108.

⁵⁷“Legjislatura e 15-të e Kuvendit të Shqipërisë, seanca plenare e datës 30.10.1997”, në: *Punimet e Kuvendit 1997*, nr. 3 Kuvendi i Shqipërisë: Tiranë: 2001, f. 198-199.

gjenerali Alexander Löhr, i tërhoqi trupat nga Greqia, Maqedonia dhe Shqipëria dhe i drejtoi ato për në veri, në frontin kryesor gjermano-rus të luftimeve. Shkodra shërbeu si porta e vetme dalëse dhe raportet gjermane thonë se 65 mijë njerëz kaluan që këtej.⁵⁸ Vëzhguesit thonë se gjatë evakuimit autokolonat drejt Tivarit e Podgoricës lëviznin paprerë, natën e ditën, mijëra ushtarë vinin dhe iknin, ndërsa spitalet mbusheshin e zbrazeshin.

Në verë e vjeshtë, kur njësitë e Ushtrisë Nacionalçlirimtare në Shqipëri u bënë gjithnjë e më aktive, atëherë gjermanët e shtuan represionin. Në fillim të tetorit Komanda e Gruparmatës E e deklaroi Shqipërinë zonë lufte dhe që prej 3 tetorit pushteti ekzekutiv i kaloi komandantit të trupave gjermanë, praktikisht gjeneralit komandues të Korpusit XXI.⁵⁹ Që prej këtij çasti mori fund ajo që deri atëherë ishte quajtur *pavarësi relative*. Veprimet që pasuan ishin dorëheqjet e Këshillit të Regjencës dhe të qeverisë së fundit kuislinge, më 27 tetor. Po atë ditë, në kuadër të planit gjerman të evakuimit, Shtabi i Korpusit XXI u largua nga Tirana për në Shkodër dhe vendin e tij e zuri Divizioni 297 i po këtij Korpusi.

Po çfarë ndodhi më konkretisht në Shkodër? Ndryshe nga Tirana, ku për njëzet ditë u luftua rrugë më rrugë e në barrikada, madje dhe nga dritaret e shtëpive, në Shkodër komanda gjermane u kujdes ta mbante qytetin të paprekur për aq kohë sa aty kishte një prani ushtarake dhe për më tepër vinin vazhdimisht të plagosur nga Shqipëria, Greqia, Mali i Zi dhe nga Kosova. Një raport i Sadik Bekteshit, komandanti i Grupit partizan të Shkodrës, më 15 nëntor, jep të dhëna të rëndësishme për gjendjen në Shkodër. Sipas atij raporti, përveç kolonave që vinin dhe iknin, në Shkodër ishte stacionuar një forcë që vlerësohej të ishte tre deri në katër mijë ushtarë gjermanë. Përveç kazermave italiane dhe godinave të tjera, shkolla etj., një lagje si ajo pranë varreve të reja katolike, u zbraza nga popullsia dhe aty u strehuan ushtarët gjermanë. E njëjta gjë u bë edhe në disa fshatra, si në Gur i Zi, Renc (aty ngritën edhe depo e llogore), në Shtoj, Vrakë dhe Kastrat.⁶⁰ Në shërbim të mbajtjes së qetësisë në

⁵⁸Arkivi i Institutit të Historisë [më tej: AIH], J-38, Dokumente gjermane, T. 311, bobina 185, nr.i dokumentit 65721/10, Gruparmata E. Urdhra, raporte, korrespondencë mbi zbrazjen e Greqisë, Shqipërisë dhe Maqedonisë.

⁵⁹Po aty, Sipas këtij dokumenti, vendimi për ta deklaruar Shqipërinë zonë lufte u mor më 2 tetor dhe më 4 tetor 1944 iu bë i ditur komandës së trupave në Shqipëri.

⁶⁰AQSH, F. 14/AP-Str. V. 1944, Lista 1/1, D. 120. Raporte nga Shkodra.

Shkodër, komandanti i trupave gjermanë ndërtoi një unazë mbrojtëse për të penguar hyrjen e formacioneve partizane në qytet. Menjëherë ai ndaloi qarkullimin e qytetarëve gjatë natës, ashtu siç ndaloi përdorimin e biçikletave në çdo kohë. Me rënien e Tiranës, masat shtrënguese u shtuan edhe më tej, aq sa më 17 nëntor doli një urdhër që ndalonte të gjitha lëvizjet natën, madje ndaloi edhe lëvizjet dhe shërbimet e xhandarmërisë vendase.⁶¹ Më 22 nëntor, kasneci i bashkisë së qytetit njoftoi lagje më lagje qytetarët se do të pushkatohej në vend cilido, ushtarak ose civil, që do të kapej në qarkullim nga ora 18 në mbrëmje e deri më 6.30 të mëngjesit.⁶² Kjo do të thoshte se kontrollin e qytetit e kishte marrë në dorë komanda gjermane.

Pasi ra Tirana, po kështu në veri Gjakova (10 nëntor) dhe Prizreni (17 nëntor), për komandën gjermane ishte e qartë se goditja e rrugëkalimeve për në Shkodër, si nga Tirana, ashtu edhe nga Prizreni e Kukësi, do të ishin objektivi kryesor i partizanëve. Prandaj tërheqja e shpejtë e autokolonave të fundit drejt Podgoricës ishte nga detyrat më urgjente. Dihej po ashtu se për të gjitha formacionet partizane objektivi i parë ishte Shkodra dhe më tej marshimi i tyre në Mal të Zi, Bosnje, me synim Berlinin, siç ishte urdhëruar nga Shtabi i Përgjithshëm. Në këto rrethana detyra kryesore e gjermanëve ishte mbajtja me çdo kusht e Shkodrës, derisa të hapej rrugëkalimi përmes Malit të Zi.

Ndodhi ajo që pritej, rreth gjashtë mijë partizanë, inkuadruar në brigadat VI, VII, XXII, XXIII, XXIV dhe në Grupin partizan të Shkodrës, që marshuan nga veriu dhe jugu, u gjendën në portat e këtij qyteti dhe në mjaft shkrime historike tanimë janë përshkruar me hollësi veprimet e formacioneve të mësipërme. Përpjekja e parë për të kaluar Drinin, në juglindje të Shkodrës, u shënuar më 21 nëntor, por pa sukses. Më tej, nga 23 deri më 28 nëntor, pra gjashtë ditë, luftimet në jug, lindje dhe verilindje të Shkodrës, në Beltojë e Bërdicë, në Vaun e Dejës, kalimi i Drinit, luftimet në Bardhaj, Kullat e Boksit, Ura e Mesit etj., të gjitha së bashku ishin një trysni që e vunë në vështirësi komandën gjermane. Në ditarin e njërit prej oficerëve të Wehrmacht-it, që është përkthyer dhe depozituar në Arkivin e Shtetit dhe që është përmendur nga studiuesit tanë, megjithëse në një kontekst tjetër, tërheq vëmendjen preokupimi i

⁶¹ *Po aty*, F. 346/Prefektura Shkodër, Shkresë e datës 17.11.1944 që komandanti i Batalionit Taraboshi, Hasan Isufi, ia dërgon Prefekturës dhe komandave të tjera të policisë lokale, V. 1944, D. 163.

⁶² *Po aty*, F. 346/Prefektura Shkodër, V. 1944, D. 17.

gjermanëve për të mbajtur pikëmbështetjet përreth Shkodrës. Majori Behn tregon se reparti i tij që vendosur në Juban dhe se më 20 nëntor ai dhe pjesa e mbetur e Korpusit XXI, bashkë me gjeneralin komandues Ernst von Leyser, u larguan nga Shkodra, ndërkohë që aty kishte mbërritur Divizioni 297. Gjithnjë sipas këtij burimi, më 22 nëntor në Podgoricë ka zbritur gjenerali Lühr i Gruparmatës E dhe aty është këshilluar me gjeneralin Leyser për rrugëkalimin e ri, pasi rruga për në Nikšić vlerësohej e pakalueshme. Drejtimi i ri u caktua më në lindje, nëpër kanionin e lumit Morača, për të mbërritur në Kolashin dhe Mateshevo.

Por për këtë rrugëkalim të ri kishte dy vështirësi: më parë duhej të ngrihej ura e shkatërruar e Bioçe-s, ku do të kalonin mjetet dhe trupat dhe për atë që do të mbante ngritja e urës, në Shkodër do të duhej të pengohej marshimi i formacioneve shqiptare në ndjekje të gjermanëve. Ura e Bioçe-s u kthye një odise më vete. Ajo u ngrit dhe u shkatërrua disa herë, punohej natën dhe bombardohej ditën nga avionët britanikë. Në Shkodër partizanët shqiptarë tentonin çdo ditë të thyenin mbrojtjen gjermane. Majori Behn, i cili i ndiqte zhvillimet nga Bioça, në shënimet e 22 nëntorit shkruan se synimi ishte “të thyheshin sulmet e armikut në pozicionin e fortifikuar në jug të Shkodrës, po ashtu dhe tentativat për t’u hedhur në Vaun e Dejës”. Më 23 nëntor ka shënuar se “armiku tentoi të hidhej në anën tjetër të Drinit në lindje dhe juglindje të Shkodrës”. Një ditë më vonë: “Banda e fortë me një kompani, e cila kaloi Drinin në Vaun e Dejës dhe avancoi drejt veriperëndimit, u hodh mbrapsht ... Në zonën e Shkodrës sulmet e forta të armikut u thyen pjesërisht me kundërsulm.” Më në fund, në shënimet e datës 27 nëntor është shkruar: “Pas veprimit luftarak të armikut, sigurimi në lindje të Shkodrës është i pamundur. Ka pasur 6 të vdekur, 12 të plagosur. Për arsye përforcimi u dërgua nga Shkodra dega e tankeve gjuajtës 297.”⁶³ Me fjalë të tjera, pas kapërcimit të Drinit në lindje dhe përforcimeve në veri, nga koha në kohë Shkodra pritej të binte në duart e Ushtrisë Nacionalçlirimtare. I vetmi pozicion që mbahej ende i fortifikuar nga gjermanët dhe i pakalueshëm mbetej Ura e Bahçallëkut në jug. Sidoqoftë trysnia përreth Shkodrës e bëri të detyrueshme zbrazjen e saj, edhe pse ura në Bioçe nuk ishte ringritur ende.

⁶³*Po aty*, F. 41/Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacionalçlirimtare, V. 1944, D. 177, “Ditar i majorit Behn, Korparmata XXI [malore]”.

Këto janë ditët e fundit të luftës në Shkodër, për të cilat nuk mund të thuhet se luftimet ishin sporadike, siç ka ndonjë opinion. Të dhënat që u thanë më sipër, megjithëse tepër përmbledhtas, dëshmojnë se ky qytet, më i rëndësishmi pas Tiranës, ra për shkak se u ngushtua dara e rrethimit, që do të thotë se ai u lëshua me luftë. Në çastet e fundit ai u braktis, sepse nuk mund të mbahej edhe më tej i pushtuar. Po pse nuk pati një dëshmi “zyrtare” nga ata që e mbajtën në rrethim qytetin se kur ai u zbraz saktësisht? Kjo është një pyetje që mbetet përherë varur, si lavjerrës. Sipas meje, dy janë arsytet. *E para*, për kohën që flasim, brenda në qytet nuk kanë qenë të pranishme njësi të organizuara të luftës. Për shembull, për shkak të represionit, jo vetëm gjerman, Grupi partizan i Shkodrës e kishte të pamundur të vepronte brenda në qytet. Më 1 nëntor Shkodra u shpall zonë operacionesh luftarake dhe, në ujdi me gjermanët, nacionalindependentët krijuan *Komitetin Administrativ të Përkohshëm* që kishte në krye Gjon Mark Gjonin dhe Sylço Bushatin. Ky komitet krijoi Komandën e Përgjithshme të Fuqive të Armatosuna Kombëtare me komandant Mark Gjomarkaj. Përveç Hasan Isufit, komandant i Batalionit *Taraboshi*, që gjermanët e veçonin si dorë të fortë dhe ndër më të besuarit, Mark Gjomarkaj e përforcoi mbajtjen e rendit, duke caktuar kolonel Osman Gazepin komandant të Fuqive të Armatosuna për *Platzkomandën* e Shkodrës.⁶⁴ Në kuadër të këtyre masave, kjo Komandë lëshoi edhe një urdhër, sipas të cilit nëse kapej një element turbullues, ai pushkatohej në vend dhe kryetari i familjes që strehonte komunistët po ashtu dënohej me vdekje, atij i digjej shtëpia dhe i dëbohej familja. Përkundër tyre, denoncuesit stimuloheshin me shpërblime nga dy mijë deri në gjashtë mijë franga shqiptare.⁶⁵ Kjo do të thotë se në Shkodër ishte vështirë edhe për veprimtaritë ilegale e jo më për ato publike. Derisa mbërriti Divizioni II i UNÇ, Grupi partizan i Shkodrës u strehua në rrethina, pa ndërmarrë veprime të tjera, sepse siç raportonte Sadik Bekteshi, “jemi të rrethuem nga të gjitha anët, njerëzit janë pa eksperiencë luftarake dhe të armatosur keq, afër një e treta pa armë.”⁶⁶ Shkurt, as para dhe as natën e 28 nëntorit brenda në qytet nuk ka pasur njësi të organizuara ushtarake, që do të thotë se ato kanë qenë në distancë me kundërshtarin. *E dyta*, është vërejtur se rruga Shkodër-Podgoricë gjatë

⁶⁴*Po aty*, F. 346/Prefektura Shkodër, V. 1944, D. 11.

⁶⁵*Po aty*, F. 270.18/Këshilli Administrativ i Përkohshëm, Shkodër, V. 1944, Lista 1, D. 1.

⁶⁶*Po aty*, F. 14/AP-Str. V. 1944, Lista 1.1, D. 120, “Raporte nga Shkodra”.

gjithë nëntorit përgjithësisht ka qenë e hapur, megjithëse kishte një urdhër të Enver Hoxhës që në këtë rrugë të jepej goditja kryesore. Për këtë Hoxha e ka qortuar Shtabin e Korparmatës I në një urdhër tjetër, më 26 nëntor.⁶⁷ Megjithatë, edhe më tej kjo detyrë nuk u zbatua. Vlerësoj se deri më 22 nëntor forcat e UNÇ në Shkodër ishin të pamjaftueshme për aksione të këtij lloji dhe angazhimi i tyre në malësitë e veriut kundër nacionalistëve, gjermanëve ua bëri më të lehtë tërheqjen. Ajo çka ende mbetet e paqartë është pse edhe pas kësaj date, kur partizanët krijuan epërsi numerike, kjo rrugë nuk u pre asnjëherë. Duket se sulmet e përsëritura të partizanëve kundër pikëmbështetjeve gjermane, më shumë se për të dëmtuar armikun kishin qëllim ta largonin atë nga Shkodra. Kështu ndodhi edhe natën e 28 nëntorit, kur thuhet se ishte planifikuar një goditje në qytet, por që nuk u realizua dhe, për më tepër, rruga e tërheqjes për në Han të Hotit u la përsëri e lirë. Kjo duhet të jetë arsyeja që lëvizja e autokolonës së fundit nuk u diktua dhe po ashtu nuk u shënuar as koha kur ajo la qytetin. Përplasja që ndodhi në Koplík mëngjesin e datës 29 nëntor me forcat e Brigadës VI, pra 17 kilometra larg Shkodrës, është një e dhënë e vlefshme që tregon se gjermanët e kishin lënë qytetin jo më shumë se tri ose katër orë më parë, domethënë mjaft pas mesnatës. Megjithatë edhe kjo e dhënë nuk është e mjaftueshme për të shkuar tek koha e saktë e largimit gjerman.

Këto ishin burimet shqiptare për fundin e luftës në Shqipëri dhe kohën kur u çlirua Shkodra. Nëse ato nuk na ndihmojnë drejtpërdrejt në dilemën 28 apo 29 nëntor, leximet e tërthorta na çojnë tek e vërteta. Por në leximet e tërthorta ka gjithmonë subjektivizëm e jo rrallë spekulime. Kështu që na duhet të shohim edhe burime të tjera.

Vështrim në burimet gjermane

Dokumentet e pushtuesit marrin rol të dorës së parë, sidomos kur burimet vendase shfaqen me mungesa dhe pasiguri. Kohë më parë në Tiranë u botua një përmbledhje me dokumente perëndimore, që u përkasin viteve 1943-1945, ku është edhe një raport përfundimtar i Wehrmacht-it për Shqipërinë. Raporti është i vitit 1945 dhe hartuesi i kësaj përmbledhjeje thotë se e ka gjetur në arkivat e Washington DC. Kur doli ky libër, disa media komentuan nga ky raport frazën e mëposhtme:

⁶⁷ *Dokumente të Shtabit të Përgjithshëm ...*, f. 329.

“Trupat e fundit gjermane u larguan nga vendi më 4 dhjetor 1944”.⁶⁸ Lidhur me këtë na duhet të sqarojmë, e para, se raporti është i njohur për studiuesit tanë, pasi ai është përkthyer nga gjermanishtja dhe gjendet prej vitesh në fondet e Institutit të Historisë në Tiranë dhe, e dyta, data e mësipërme duhet shpjeguar, për të mos lënë pas keqkuptime. Ne shqiptarët në të gjitha rastet kemi pasur dhe kemi për referencë 28 ose 29 nëntorin, si datë e tërheqjes së trupave gjermane, duke iu mbajtur kriterit të zbrazjes së qytetit të fundit, ndërsa vetë gjermanët, së paku nga ky raport, duket se i janë mbajtur kriterit kur është kaluar kufiri shtetëror.

Po ku mbetën dhe çfarë bënë gjermanët pesë ditë, deri sa ata e lanë kufirin shqiptar? Rasti është i thjeshtë. Për shkak se javën e fundit të nëntorit partizanët krijuan epërsi numerike përreth Shkodrës, komanda e Divizionit 297 u detyrua ta lironte qytetin. Por Korparmata XXI kishte mbetur e bllokuar në Podgoricë dhe përreth saj, në pritje të ngrihej ura mbi lumin Morača. Për këtë arsye komanda gjermane kishte zgjedhur që më parë kodrat në kufirin midis Shqipërisë dhe Malit të Zi si pika më e përshtatshme për të ndërtuar një vijë mbrojtjeje dhe ku do të vendoseshin trupat gjermane të sapotërhequra nga Shkodra. Detyra e tyre ishte të ndalnin forcat partizane që do të viheshin në ndjekje nga Shqipëria, deri sa të hapej rrugëkalimi për në veri. Këto kodra i përkasin fshatit Bozhaj, që është edhe pika kufitare me të njëjtin emër ose Hani i Hotit për shqiptarët. Duket se gjermanët nuk i kanë kushtuar vëmendje të precizojnë ku u vendosën trupat në raport me kufijtë shtetërorë të dy vendeve. Me interes për ne është se data 4 dhjetor që e përmban raporti i sipërpërmendur gjerman si ditë të largimit nga Shqipëria, ka lidhje me këtë detyrë taktike të luftimit dhe me këtë vendndodhje që gabimisht është marrë si tokë shqiptare.*

Lidhur me dokumentet e tjera gjermane, aq sa kemi ne në dorë, ashtu si dokumentet shqiptare, duhet edhe ato t’i shohësh tërthorazi. Kjo ka

⁶⁸ Bernd Fischer, *Shqipëria 1943-1945. Një vështrim përmes dokumenteve perëndimore*, Instituti i Studimeve Ndërkombëtare [AISS], Tiranë: 2012, f. 258. Në raportin e përmendur thuhet se pas dorëheqjes së Këshillit të Regjencës dhe të qeverisë më 27 tetor 1944, situata që pasoi mund të përshkruhet vetëm si gjendje lufte dhe se kjo periudhë është paraqitur në një raport tjetër të posaçëm. Ky raport duhet të përmbajë hollësi me interes, por deri më tani nuk është bërë i njohur.

* Më gjerësisht kundërshtimet rreth tezës së largimit të gjermanëve nga Shqipëria më 4 dhjetor 1944 janë shprehur në intervistën që autorja i ka dhënë *Gazetës Shqiptare*, më 8 nëntor 2014. Intervista është përfshirë në këtë libër dhe mban titullin “Replikë me Profesor Bernd J. Fischer për ikjen e pushtuesve gjermanë nga Shqipëria”.

lënë hapësirë për subjektivizëm dhe më keq akoma për spekulime. Po i kthehem edhe një herë ditarit që ka mbajtur majori gjerman Behn. Në shënimet e datës 28 nëntor ai ka thënë: “Gjatë veprimtarisë së gjallë luftarake për qark Shkodrës humbjet tona ishin tre të vrarë, katër të plagosur. Për arsye të goditjes së plotë, armiku humbi ose iu zhdukën dy mitraloza. Tërheqja nga Shkodra kaloi. Veprimtari e gjallë e gjuajtësve. Një Spitfajter (spitfire) u rrëzua nga një top i yni...” Siç duket nga përmbajtja e tekstit, fjala duhet të jetë për përpjekjen që është bërë më 28 nëntor me Batalionin II të Grupit të Shkodrës në kodrat e Kotrullit, gjë që e kanë vërejtur dhe të tjerë. Po ashtu nga përmbajtja, nuk ka dyshim se shënimet janë hedhur në fund të asaj dite. Në këtë copëz teksti fjalia që tërheq vëmendjen është: “*Tërheqja nga Shkodra kaloi*”. Siç është thënë më parë në këtë shkrim, në shënimet e M. Terihatit flitet se pasi ra nata armiku u tërhoq dhe të nesërmen janë gjetur disa gjermanë të vrarë. Për këtë çast nuk ka asgjë më shumë. Po ku shkuan njësitë ndërluftuese? Për batalionin e Shkodrës thuhet se atë natë ai zbriti në fushë dhe në marrëveshje me Brigadën XXII po përgatiteshin të hynin në qytet. Ndërsa për forcat gjermane në atë përpjekje thuhet se ato u tërhoqën dhe vetëm kaq.

Me të drejtë, përkrahësit e 28 nëntorit shprehjen në ditarin e majorit Behn “*Tërheqja nga Shkodra kaloi*” e lexojnë në mbështetje të versionit të tyre. Por, përqendrimi i tepruar në këto pak fjalë kthehet në fiksacion, në qoftë se ky pohim nuk shihet i lidhur edhe me pohime të tjera. Për shembull, majori Behn vërtet e ka thënë këtë në shënimet që ka hedhur natën e 28 nëntorit. Por ai një natë më pas ka sjellë të dhëna shtesë dhe që kanë ngjarë nga njëra natë në tjetrën. Ithtarët e 28 nëntorit këto nuk i thonë. Punë e tyre, le të mos i thonë, por cilido që mëton se shkruan histori, se bën shkencë, nuk i lejohej t’i cungojë të dhënat. Atëherë, le të kthehemi tek Ditari i gjermanit: “29.11.1944. Ngjarje shërbimi me rëndësi nuk ka. Dalja e bukur e hënës. Në mbrëmje me Halingerin dhe Schaldachin luajtëm skat, pimë vermut. Koha është e bukur ... Ngritja e urës së re në Bioçe përparon sipas planit. Urat që kalojnë në Bunë dhe Drin të Shkodrës u shkatërruan. Mbraparoja gjendet në Koplik. Gjatë sulmeve rrugore nga ana e aeroplanëve të armikut me fluturim të ulët humbjet tona nuk dihen. Disa makina jashtë përdorimit.”⁶⁹ Në këto

⁶⁹AQSH, F. 41/Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacionalçlirimtare, F. 41/Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacionalçlirimtare, V. 1944, D. 177, “Ditar i majorit Behn ...”.

shënime dy të dhëna janë në interes të kësaj teme. E dhëna e parë: “*Urat që kalojnë në Bunë dhe Drin të Shkodrës u shkatërroan*” dhe, e dyta: “*Mbraparoja gjendet në Koplik*”. Gjithkush e di se urat u shkatërroan gjatë natës së 28 nëntorit. Kuptohet pse kjo e dhënë nuk u shënuar në ditar më 28 nëntor, pasi kur janë hedhur shënimet, urat ishin ende më këmbë. Për sa i përket vendndodhjes së praparojës, nuk përjashtohet ndonjë pasaktësi. Dihet se mëngjesin e asaj dite, praparoja gjermane është përplasur me forcat e Brigadës VI, por kjo e fundit duket se nuk është angazhuar më tej në luftime. Që nga Kopliku ajo ka marrë rrugën për në veri, në Reç, në Zagorë, në Leqet e Hotit dhe e ka kaluar kufirin në Deçiq të nesërmen në orën 9.30. Çfarë ka ndodhur me praparojën gjermane nuk kemi të dhëna, nëse ajo ka qëndruar në Koplik, apo më tej, në Bajzë ose në Han të Hotit. Apo ndoshta kronikani ka përdorur emërtimin Koplik, duke nënkuptuar gjithë shtrirjen e tij administrative. Ajo që dimë është se pas Brigadës VI, e vetmja që u gjend përballë praparojës së larguar nga Shkodra është Brigada XXII dhe kjo ka ndodhur më 2 dhjetor, jo në Koplik, po 15 km më tej, në Bozhaj.

Atëherë çfarë duhet të kuptojmë me fjalinë “*Tërheqja nga Shkodra kaloi*”? Është rasti t’i kthehemi edhe njëherë ditarit të Sejdit Avdisë, zëvendëskomisar i Brigadës XXIII. Në shënimet e tij në mbrëmjen e datës 28 nëntor thotë që “sot informohemi se forcat armike janë larguar nga Beltoja dhe Bërdica, *gjithashtu janë pamun lëvizje tërheqjeje (të gjermanëve) edhe nga Shkodra.*”⁷⁰ Duke vazhduar më tej, ka edhe dëshmi të tjera se më 28 nëntor ka pasur vërtet tërheqje të gjermanëve nga Shkodra, se “ushtarët e Gestapos e lanë selinë italiane më datë 28” etj. Ajo çka disa e kundërshtojnë, midis tyre edhe unë, janë përfundimet kategorike, të tilla si “triçikli i fundit me ushtarë gjermanë është larguar në drekën e 28 nëntorit” etj. Kjo tregon se zbrazja e qytetit ka filluar që gjatë ditës dhe ndoshta ata gjermanë që luftuan gjithë ditën në kodrat e Kotrullit të Madh dhe që “u tërhoqën kur ra nata”, ndoshta ata dhe të tjerë nuk u kthyen më në kazeremat prej nga dolën atë ditë. Por fakt është se atë natë [nuk po them deri në cilën orë] praparoja ishte në Shkodër. Praparoja është njësi e organizuar dhe me detyra luftarake të përcaktuara qartë. Në terminologjinë ushtarake mund të flitet për tërheqje, kështu edhe në rastin e Shkodrës, por kjo nuk do të thotë se praparoja e lë një pozicion luftimi, një rrugë, një qytet etj., në të njëjtën kohë me trupën ushtarake, ku

⁷⁰ *Po aty*, F. 197/Brigada XXIII e UNÇSH, V. 1944, L. 1, D. 15.

praparoja është pjesë. Nuk marr përsipër ta trajtoj me kompetencë këtë çështje në pikëpamje ushtarake, por është e njohur se në rastin e tërheqjes gjermane nga Shqipëria, praparoja ka kryer jo vetëm detyra të sigurimit të trupës që tërhiqet në shpinë të saj, por edhe detyra të tjera, madje të vështira, siç është shkatërrimi i urave.

Po sa është kjo trupë, për të cilën themi se u tërhoq e fundit nga Shkodra dhe që kur e përmendin, gjermanët përdorin termin *praparojë*? Me njohjen e deritashme kjo pyetje vështirë se merr përgjigje të saktë. Dikush thotë se bëhet fjalë për një garnizon të vogël, aq sa “do ta dëbonte nga Shkodra edhe një batalion partizan”.⁷¹ Dikush tjetër e kundërshton me mendimin se katërmijë ushtarë e oficerë gjermanë nuk mund të konsiderohen garnizon i vogël.⁷² Nuk di të them përbërjen organike të kësaj trupe e as numrin e ushtarëve e oficerëve. Sidoqoftë, mendoj se nuk është fjala për një garnizon të vogël, që mund ta përzinte me lehtësi edhe një batalion partizan. Por nuk mendoj të kenë qenë as tre e as katërmijë ushtarë, shifër që për një kohë mbeti konstante në Shkodër, por që nga dita në ditë e sidomos ditën e fundit ajo duhet të jetë reduktuar mjaft. Pasi shkatërroi urat, eksplodoi municionet, dogji disa kazerma ushtarake, vetëm atëherë praparoja la qytetin dhe zuri një vijë mbrojtjeje në kufirin shqiptaro-malazez, vendndodhje ku ajo i priti partizanët nga Shqipëria. Më datë 3 dhjetor ajo u ndesh me Brigadën XXII. Këtë çast e përmend majori Behn në ditarin e vet: “E diel, 3. 12. 1944. Shumë sulme të armikut të përbërë prej 500 banditësh [partizanësh, AL] të drejtuara kundër barrierës në verilindje, në skaj të liqenit të Shkodrës, u sprapsën.”⁷³ Ajo që mund të komentohet në pikëpamje taktike është se një forcë me 500 ushtarë në mësymje, si rregull, mund të godasë kur krijon epërsi numerike të paktën dy herë më shumë se kundërshtari në mbrojtje. Kësisoj mendoj se praparoja gjermane nuk i ka kaluar tre ose katërqind vetë. Këta ishin të fundit ushtarë që u tërhoqën nga Shkodra.

Ka edhe dokumente të tjera të Wehrmacht-it të cilat bëjnë fjalë për tërheqjen nga Shkodra. Në shkurt të vitit 2002, koloneli gjerman Wolfram Hoffman, atë kohë këshilltar ushtarak në Ministrinë e Mbrojtjes të Shqipërisë, sollti një a dy prej këtyre dokumenteve. Me atë rast koloneli Hoffman komentoi se sipas dokumenteve, “Korpusi XXI alpin... lëshoi

⁷¹ V. Baruti, “28 Nëntori i tretë ...”, f. 365.

⁷² S. Onuzi, *Data e çlirimit...*, f. 48.

⁷³ *AQSH*, F. 41/Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacionalçlirimtare, V. 1944, D. 177, “Ditar i majorit Behn...”.

më 29. 11. 1944 qytetin e fundit të madh të Shqipërisë, Shkodrën. Prandaj kjo datë mund të quhet fundi i pushtimit të Shqipërisë”. Dokumentet e sidomos komentet e këshilltarit Hoffman u pritën me reagime të kundërta në Tiranë. Disa entuziastë mbushën gazetatat se dokumentet ishin “shuplakë mbi falsifikatorët e historisë” dhe se ky ishte fundi i dilemës së çlirimit. Të tjerë hodhën dyshime, sepse aty nuk përmendej gjëkund data 29 dhe se, sipas tyre, nuk mund të ishte kusht që shënimet e datës 30 nëntor në një ditar të përmbanin medoemos veprimet e një dite më parë. Ja një pjesë e njërit prej dy dokumenteve dhe më i rëndësishmi, i cili është marrë nga një përmbledhje me disa vëllime, “Ditari sekret i Komandës së Wehrmacht-it në Luftën e Dytë Botërore 1939-1945, Vëllimi 11”. Në të thuhet: “30.11.44... *Adria-Front: XXI. Geb. A. K.: Skutari geräumt. Nachhuten im Absetzen in Aufnahmestellung an Nordostausläufen Skutari-See.*” [Në shqip: Fronti i Adriatikut. Korparmata XXI malore zbrazti Shkodrën. Preparoja tërhiqet në pozicion pritjeje në bregun verilindor të liqenit të Shkodrës].⁷⁴ Mendoj se këshilltari gjerman në Ministrinë shqiptare të Mbrojtjes është nxituar me komentet e veta, por kjo nuk është fort e rëndësishme. Profesionalisht e qortueshme është se studiuesit tanë, jo pa përvojë, për gati një vit në shkrimet e tyre iu referuan komentit të gjermanit mbi dokumentet dhe jo vetë dokumenteve. Derisa doli më në fund se, me gjithë vlerën e tyre, ato nuk sillnin ndonjë të re më shumë nga sa njihej dhe ishte thënë.

Dokumente të ngjashme vijnë edhe nga burime të tjera gjermane. Por asnjëri prej tyre nuk jep të dhëna të precizuara për kohën kur u largua nga Shkodra preparoja gjermane. Duke iu përmbajtur një pohimi të Bernd Fischer-it, ai thotë që “... nëse do të mbështeteshim në burimet gjermane për datën, materiali arkivor që unë kam parë, më sugjeron se ata kanë përdorur datën 29 si ditën e tyre zyrtare të tërheqjes”.⁷⁵ Vetëm kaq dhe as kemi pse kërkojmë më shumë, kur është fjala thjesht për një intervistë në gazetë. Ndryshon puna me studimet. Një studiues i ri ushtarak, dr. Marenglen Kasmi ka botuar së fundmi një libër me interes për pushtimin gjerman në Shqipëri. Bazuar në të dhënat dokumentare të Wehrmacht-it, ai i mbahet mendimit se trupat gjermane e lëshuan qytetin e fundit më të

⁷⁴sq.wikipedia.org/wiki/Dita_e_Çlirimit_Kombëtar. Ky dokument është përdorur nga shumë autorë që kanë folur dhe komentuar e madje e kanë përkthyer në versione të përafërta. Zgjedha të përdor versionin e sjellë nga autori Kasem Biçoku, pasi ai i ka shprehur më gjerësisht kundërshtimet e tij për komentet që iu bënë këtij dokumenti.

⁷⁵ Gazeta *Korrieri*, 28 nëntor 2004.

madh verior të Shqipërisë, Shkodrën, më 29 nëntor 1944.⁷⁶ Në mbështetje të këtij pohimi ai sjell dhe referencat përkatëse arkivore, por më e mira do të ishte nëse, përveç referencës, të kishte dhënë edhe tekstin e burimit. Dr. Kasmi ka cituar një raport sekret të Komandantit të Përgjithshëm të Juglindjes, po ashtu i datës 30 nëntor 1944, në të cilin thuhet: “... b) *Fronti i Adriatikut: Korparmata XXI Malore: Shkodra u lëshua, praparoja e Divizionit 297 arriti në Koplík (15 km në veriperëndim të Shkodrës)*...”⁷⁷ Por, me gjithë interesin që paraqet, as ky raport nuk na ndihmon për të kuptuar se kur saktësisht “*Shkodra u lëshua*”. Madje një raport tjetër i datës 29, një ditë luftë, na kthen aty ku ishim, gati për t’i hapur diskutimet nga e para. Aty është shkruar: “*Adria-Front: XXI. Geb. A.K.: Räumung Sperrstellung Skutari unter Bandendruck 28.11. abends angelaufen.*” Këtë frazë autori Kasmi e ka sjellë në shqip si më poshtë: “*Fronti i Adriatikut. Korparmata XXI Malore: Pozicioni pengues Shkodra është lëshuar nën presionin e bandave në mbrëmjen e datës 28.11.*”⁷⁸ Një dokument që nuk mund të anashkalohej. Duket se përkthimi është korrekt, me një përshtatje të lehtë sipas natyrës së shqipes. Megjithatë m’u desh të këshillohesha me specialistë të gjermanishtes dhe ata më shpjeguan se në këtë rast emri foljor *räumung* [zbrazje, tërheqje, evakuim, lëshim] është përkthyer jo me emër, por me foljen përkatëse, në kohën e kryer të pësorës [është lëshuar]. Por pikërisht kjo *përshtatje e lehtë*, me qëllim që struktura e fjalisë të tingëllonte më shqip, ka prekur informacionin në pikën më delikate të kësaj historie, duke dhënë si të kryer, pra si të mbaruar, një proces që në fakt në ditën thuhet se ka filluar: *28.11. abends angelaufen* [filluar më 28.11. në mbrëmje]. Atëherë përkthimi korrekt do të ishte ky: “*Lëshimi i pozicionit pengues Shkodra nën presionin e bandave [ka] filluar më 28.11. në mbrëmje*”. Në përfundim, nuk ka dyshim [së paku sipas këtij shënimi] se më 28 nëntor në mbrëmje ka pasur një urdhër për evakuimin përfundimtar nga Shkodra dhe po atë mbrëmje ka filluar lëvizja e trupave të mbetura në drejtim të Podgoricës. Po trupat e fundit kur e kanë lënë Shkodrën? Në përgjigje të kësaj pyetjeje të përsëritur, ajo që dimë është se gjatë natës në këtë qytet ka pasur prani trupash dhe ato kanë ndërmarrë veprime ushtarake destruksioni, eksplozimesh, madje

⁷⁶ Marenglen Kasmi, *Pushtimi gjerman i Shqipërisë (1943-1944). Një këndvështrim në dritën e dokumenteve gjermane*, Tiranë: Filara, 2013, f. 195.

⁷⁷ Po aty.

⁷⁸ Po aty.

kanë shkaktuar edhe viktima dhe të gjitha këto kanë ndodhur rreth mesnatës së asaj date. Por, le të vijojmë më tej, për të shkuar te koha e saktë.

Burimet e fundit për natën e fundit të gjermanëve

Pasi kemi parë burimet shqiptare, po ashtu edhe ato gjermane, me aq sa kemi në dorë, të fundit që i vijnë në ndihmë kësaj trajtесе janë burimet e tjera të huaja. Përvoja ka treguar se në përgjithësi njohja e këtyre burimeve mbetet ende parësore për të ndërtuar dhe shpjeguar historinë e shqiptarëve. Ndër studiuesit e huaj, britaniku Owen Pearson është ndoshta i vetmi që deri më sot ka dhënë historinë më të plotë për Shqipërinë e shekullit XX. Gati dymijë faqe histori janë fryt i interesit të tij të hershëm për këtë vend, që më 1936 përmes *March of Time*, janë po ashtu fryt i lidhjeve të afërta që Pearson krijoi me oborrin e mbretit shqiptar në mërgim, por edhe me Shqipërinë e Hoxhës, të cilën e vizitoi më 1957 dhe më 1981. Pearson e vizaton kështu natën e fundit të gjermanëve: *“Kur këto forca [të Korparmatës III – AL] pritej ta rrethonin armikun në Shkodër, gjermanët e panë veten në rrezik dhe duke përfutuar nga errësira, ata gjatë natës u tërhoqën me shpejtësi nga qyteti, një tërheqje sistematike, e disiplinuar dhe në qetësinë më të madhe, kështu që askush nuk di të thotë në çfarë ore ata u larguan.”*⁷⁹ Duket se për këtë çast as Pearson nuk ka informacione të tjera, veç atyre që janë në qarkullim dhe që tanimë janë bërë publike. Për t’u veçuar është konkluzioni i këtij autori se tërheqja gjermane në kohën kur ndodhi dhe mënyra si u realizua, ka qenë një veprim i detyruar nën trysinë e UNÇ. Madje për këtë shkak tërheqja ishte e shpejtë, e disiplinuar dhe me qetësi dhe për këtë arsye askush nuk di të thotë në cilën orë ndodhi ajo.

Megjithatë, mendimi se askush nuk di të thotë në cilën orë ndodhi tërheqja gjermane më duket disi i prerë, pasi në një rast si ky të larguarit e fundit nuk janë pak dhe në mos të gjithë, së paku disa prej tyre, mbajnë mend dhe e dinë të vërtetën. Dinë të thonë po ashtu edhe të tjerë, që i kanë vëzhguar nga jashtë veprimet. E vërteta është se ne kemi në dorë informacion të pakët rreth një çasti kohor, pas të cilit jemi mbërthyer, por, sidoqoftë, kujtimet e qytetarëve për çfarë ka ndodhur atë natë në Shkodër, nuk lënë kurrfarë dyshimi se qyteti ka qenë nën terror. Pa dyshim, këto janë dëshmi shumë të rëndësishme. Më ka mbetur në

⁷⁹ O. Pearson, *Albania in the Twentieth Century ...*, vol. 2, p. 414.

mendje një histori tronditëse për dy italianë, nga ata që iu bashkuan gjermanëve pas kapitullimit të ushtrisë së tyre. Ata ishin xhenierë dhe në Shkodër, nën mbikëqyrjen e gjermanëve, ata kishin minuar depo municionesh, institucione publike etj., por natën e 28 nëntorit ishin po ata që prenë fijet e shumë prej këtyre lidhjeve dhe në këtë mënyrë shpëtuan Shkodrën. Në çastet e fundit ata u diktuan dhe nazistët i varrosën të gjallë. Këtë histori e ka shkruar xhenieri Besnik Alibali dhe e ka përfshirë në një libër të tij “50 vjet mbi mina”. Kolonel Alibali thotë se kjo histori në Shkodër qarkullon si një legjendë dhe askush nuk di të thotë për emrat dhe varrin e tyre. Ndoshta dhe vetë historia e tyre do të ishte varrosur bashkë me ta, sikur disa robër lufte të ushtrisë naziste të mos u kishin treguar shqiptarëve për çfarë kishte ngjarë. Por as ata nuk dinin më shumë për identitetin e italianëve.⁸⁰ Nuk kam guxuar ta sjell këtë ngjarje si dëshmi, pasi edhe mua më është dukur si legjendë, pa mundur të gjeja një kufi midis të vërtetës dhe fantazisë. Por gjithçka u bë e qartë kur të njëjtën histori e ndesha përsëri këto ditë, këtë herë jo si gojëdhënë, po në një raport zyrtar të kohës. Raporti, gjithsej 169 faqe të daktilografuara, mban datën 01.01.1945 dhe i përket delegatit apostolik të Vatikanit me qendër në Shkodër, Mons. Leone Giovanni Batista Nigris, i cili shkruan për zhvillimet në Shqipëri në vitet 1938 – 1944. Praninë e këtij raporti për herë të parë e ka bërë me dije gazetarja Alma Mile katër ose pesë vite të shkuara në një të përditshme shqiptare, ndërsa njohjen me këtë raport ma mundësoi Dom Nik Ukgjini*, në famullinë e Kuklit. Pasionant pas historisë, Ukgjini e ka gjetur dhe ruajtur në arkivin e tij kopjen e raportit të mësipërm, të cilin ma vuri në dispozicion, për çka e falënderoj veçanërisht.

Po kush është diplomati Nigris dhe çfarë thotë raporti i tij? Autor i disa librave me tema kryesisht filozofike dhe historike, një diplomat energjik, Leone Nigris kishte ardhur në Shqipëri në tetor 1938, me detyrën e arqipeshkvit dhe që prej asaj kohe u vendos në Shkodër, ku ishte selia e Delegacionit të Vatikanit. Kështu që fundin e luftës ai e ndoqi pikërisht nga ky qytet dhe, siç del nga raportimet, nuk ishte aspak një vëzhgues pasiv i saj. Pas luftës, Enver Hoxha e takoi dy herë Nigrisin, me synim që qeveria e tij të siguronte njohjen e Papa Piut XII. Por në ndërkohë ndaj klerikëve në Shqipëri kishte filluar persekucioni dhe për

⁸⁰ Besnik Alibali, *50 vjet mbi mina. Fletoret e një xhenieri*, Tiranë: Flesh, 2001, f. 21-23.

* *Dom Nikë Ukgjini* – Doktor i Shkencave në Institutin Filozofik dhe Teologjik, Shkodër.

këtë shkak Selia e Shenjtë nuk dha kurrfarë mesazhi pozitiv. Atëherë Hoxha u kundërpërgjigj në mënyrën e vet, largoi Nigrisin nga Shqipëria si person të padëshiruar. Raporti i Nigrisit për pesë vitet e luftës është dëshmi e njeriut që ka njohje të lakmueshme për shumëçka, duke filluar nga gjendja e përgjithshme në vend, për të vazhduar me krahët politikë, forcat e përfshira në luftë dhe ka dhënë kështu një kronikë besnike të ngjarjeve më kryesore, të përshkruara ftohtë dhe në mënyrë të besueshme. Angelo Dell'Acqua, në Sekretariatit e Shtetit, ka shënuar se raporti i ecc.mo (fort të ndriturit) mons. Nigris është shumë interesant dhe ndër informacionet e shumta “jo pak prej tyre janë me rëndësi të veçantë për historinë”. Do të më duhet t’i referohem këtij raporti për dy a tre momente që lidhen me temën e këtij punimi. Midis ngjarjeve është edhe historia e italianëve, për të cilët shkruan Alibali. Në raport thuhet se disa robër italianë, të cilët punonin në një depo të madhe municionesh, hapën fjalë për rrezikun që i kanosej qytetit në rast shpërthimi. Atëherë një komision qytetarësh më 28 nëntor u paraqit në komandën gjermane dhe komandanti autorizoi zhvendosjen e gjithë materialit shpërthyes në breg të Bunës. Shumë veta dolën vullnetarë, siç kishte të tjerë që nuk pranuan të merren me këtë punë, “midis tyre edhe etërit jezuitë, megjithëse ata dispononin kuaj dhe qerre”.⁸¹ Çfarë mungese e ndjeshmërisë njerëzore dhe kristiane! - reagon me keqardhje Nigris. Eksplozivi dhe municionet u zhvendosën vetëm pjesërisht, kështu që atë natë shpërthimet e tronditën qytetin dhe shkaktuan dëme në shtëpitë përreth. Sipas raportit, shpërthimet janë bërë pjesë-pjesë, siç ka pasur edhe shpërthime që janë shmangur dhe që mund të sillnin katastrofën. “*Këtë e penguan vetë robërit e mirë italianë, shkruan Nigris, të cilët duke u zvarritur në terren me rrezik jete, arritën t’i prisnin fjetet e bëra gati për shpërthim të pjesës më të madhe të eksplozivit me ngarkesë të lartë. Katër robër të tjerë italianë penguan shkatërrimin e ndërtesës së madhe të Shkollës industriale duke prerë në kohë fjetet e minave. Po njëri prej tyre mbaroi në mënyrë të tmerrshme: e varrosën të gjallë kokëposhtë dhe i shkelur me këmbë që të qëndronte brenda gropës së vogël.*”⁸² Nigris komenton se kjo u bë me një egërsi të kulluar, aq sa disa gjermanë masakruan edhe një familje shqiptare, nga që dyshuan për të shtëna, që në fakt nuk ndodhën.

⁸¹“Delegazione Apostolica in Albania, Mons. Leone G. B. Nigris, Delegato Apostolico”, *Cenni sulle vicende dell’Albania dal 1938 al 1944*, 01.01.1945, p. 158.

⁸²*Po aty*, p. 158.

Për këtë familje ka shkruar edhe Ahmet Bushati, që është përmendur në këtë shkrim.

Dëshmitë e Leone G. B. Nigris përmbajnë edhe hollësi të tjera, të cilat mbeten të dhënat më të plota që kemi deri më tani për natën e fundit të luftës në Shkodër dhe, më e rëndësishmja në kontekstin e kësaj teme, që dëshmojnë për kohën e saktë të tërheqjes së gjermanëve. Në qoftë se burimet e tjera na duhej t'i lexonim tërthorazi për të shkruar tek ky çast, raporti i Nigrisit është i drejtpërdrejtë. E çuditshme, sikur ta kishte parandier se një ditë ne shqiptarët do të përplaseshim njëzet vjet pikërisht për këtë! Të mos harrojmë, komanda gjermane ndihmën e parë ua kërkoi pikërisht krerëve katolikë në Shkodër, si për mbajtjen e rendit e sidomos për strehimin e trupave dhe shndërrimin e përkohshëm të disa prej institucioneve në spitale për të plagosurit. Shënohet, bie fjala, se përveç lokaleve të shkollave publike, për trupën u morën lokalet e gjimnazit françeskan, e shkollave të murgeshave Stimatine dhe Servite, selitë e Aksionit Katolik të famullisë dhe të Fetarëve, ndërsa u kthyen në spitale Seminari dhe Kolegji Saverian etj.⁸³ Pra, diplomati Leone Nigris ka qenë pjesë e këtyre marrëdhënieve, po ashtu e zgjidhjeve. Kësisoj, nuk ka kurrfarë dyshimi se ai ishte ndër personat e mirinformuar dhe, kuptohet, hollësitë që ai sjell janë më se të besueshme. Në këtë kuadër marrëdhëniesh, duket se preokupim kryesor i krerëve të Kishës ka qenë ruajtja e qytetit, duke u shmangur shkatërrimet që pësoi Tirana. Nigris përgjegjësinë e shkatërrimeve në Tiranë ua lë partizanëve, sepse gjermanët nuk ishin të interesuar për t'u angazhuar me luftime në Shqipëri. Por në rastin e Shkodrës duket se të dyja palët ishin të interesuara për shmangien e luftimeve. Po a do të kishte shkatërrime në çastin e fundit? Ajo çka dihej ishte praktika e hedhjes në erë të urave, por dhe e ndërtesave publike. Vetë Nigris u përfshi në përpjekjet për të parandaluar izolimin e qytetit nga pjesa tjetër e vendit. Prandaj ai më 24 nëntor iu drejtua gjeneralit von Leyser me lutjen që t'i kursehej qytetit fatkeqësia me shkatërrimin e tri urave mbi Drin, Bunë dhe Kir. Ura në Vaun e Dejës ishte hedhur në erë më parë, më 21 nëntor. *“Ai [von Leyser] gjendej në Nikshiq dhe letrën time e mori më 25, por më kot prita përgjigje, thotë Nigris. Dy herë i fola për çështjen Komandantit të Garnizonit, kolonelit Shuster dhe ai më siguroi mua, Imzot kryepeshkopin, si dhe një përfaqësi qytetarësh në vizitën e lamtumirës më*

⁸³Po aty, p. 150.

27 [nëntor], se urat do të kurseheshin me kusht që komunistët të mos i sulmonin në ikje e sipër. Dhe ja: partizanët, të lajmëruar për këtë gjë nga një komision i qytetit, nuk sulmuan; megjithatë urat u hodhën në erë me gjakftohtësi dy orë para nisjes dhe saktësisht në orën dy e dhjetë minuta të datës 29! Kjo ia vuri vulën tërë një vije sjelljeje që e ligjëron thënien: *Teutonica fides, nulla fides**.⁸⁴

Ky është njoftimi i parë i rëndësishëm: urat u hodhën në erë me gjakftohtësi dy orë para nisjes dhe saktësisht [precisamente] në orën dy e dhjetë minuta të datës 29! Duket se këtë çast autori jo vetëm e ka regjistruar, por qëllimisht kujdeset për hollësitë, me siguri për shkak se në funksion të detyrës së tij, ai, bashkë me arkiveshkvën dhe një komision qytetarësh, ishte përpjekur të parandalonte shkatërrimet, kishte marrë për këtë edhe siguri e megjithatë kishte ndodhur e kundërta. Për të fiksuar një pamje më të qartë çfarë ka ndodhur ato çaste, le t'u kthehemi edhe njëherë disa dëshmime. Kristo Frashëri, ish partizan i Brigadës XXIII: "...mbas mesnate, dëgjuam një tronditje të madhe që na zgjoi nga gjumi. Ishte ora dy e ca e mëngjesit e datës 29 nëntor 1944." Leone Nigris: "Koloneli Shuster urdhëroi shpërthimet në qytet [jo vetëm urat, shënimi im, AL]. Këto pasuan menjëherë shembjen e urave me një simfoni skëterre që zgjati për më se një orë." At Zef Pllumi: "Mbas atyne bumbullimave që shpallën largimin përfundimtar të gjermanëve nuk fjeti më kurrkush n' atë natë të gjatë." Kështu, pohimet pajtohen dhe konfirmojnë njëri-tjetrin.

Siç e pamë, njoftimi i mësipërm përmban dhe hollësinë tjetër për çastin e debatueshëm të evakuimit gjerman. Sipas të dërguarit të Selisë së Shenjtë, gjithë sa u tha më lart gjermanët e bënë "*dy orë para nisjes*". Por ky çast shënohet edhe në dy fragmente të tjera të atij raportit. Në fragmentin e parë çasti i largimit gjerman përmendet në një kontekst, le ta quajmë moral. Autori i raportit është kritik me gjermanët, të cilët e quanin veten mysafirë në Shqipëri, po u sollën si pushtues; që respektonin valutën e vendit, po vodhën në Romë rezervën e arit të Bankës së Shqipërisë dhe klishtët e bankënotave. Ai nënvizon momente nervozizmi, po sidomos një lloj shthurjeje në radhët gjermane, në fakt sjellje jo karakteristike për ushtrinë gjermane. Flet si u bastisën dyqanet e Tiranës dhe si u grumbullua dhe u shit në aerodromin e kryeqytetit gjithë

* Besa e teutonëve, besa e kurrkujt [lat.]

⁸⁴ *Po aty*, p. 157.

malli i grabitur dhe si pjesa tjetër u ngarkua me kamionë për në veri. Tregon se në Shkodër vërshuan pareshtur njerëz dhe materiale, përfshirë plaçkën e vjedhur dhe se aty gjermanët shesin aq sa munden: nga makinat llogaritëse të gjilpërat e makinave qepëse, nga batanijet prej leshi të çorapet e mëndafshta, nga mobiliet tek orët e xhepit, nga gjeneratorët tek unazat e florinjta, nga qerret dhe kafshët të kutitë me ushqime dhe konserva. Kjo vazhdoi gjatë gjithë ditëve, ndërsa kolonat lëviznin paprerë, trupat vinin dhe iknin. Ky lloj tregu vazhdoi madje edhe ditët e fundit kur lëvizjet ishin më të pakta dhe për këto ditë Nigris shkruan si më poshtë: *“Në Shkodër gjermanët vazhduan të bënin pazar: atë që s’e shisnin dot as e merrnin me vete, e shkatërruan. Po numri i tyre pakësohej çdo ditë; të fundit u nisën në orën 4 të datës 29, duke e mbyllur me turp qëndrimin e tyre në Shqipëri.”*⁸⁵ Në fragmentin e dytë largimi i gjermanëve përmendet në një kontekst ushtarak. Pasi ka shpjeguar se katër brigada partizane po e ngushtonin lakun përreth Shkodrës dhe se forca të reja pritej të vinin, nga Lezha, nga Puka, mbase edhe nga Tivari, Leone Nigris thotë: *“Dita e caktuar për sulm ishte 29, po disa grupe ishin brenda në qytet që më 28, ato qarkullonin me kujdes, merrnin masa që centrali elektrik t’i jepte dritë qytetit në orën 17 për mesazhin që kryetari i qeverisë do të mbante në Radio-Tirana. Për fat, kontingjentet e fundit gjermane u nisën në orën 4 të 29-ës, kështu që partizanët u futën në qytet pa mundim. Zbraznin armë marrëzisht në shenjë feste, të shtëna dhe shpërthime vinin pothuaj nga të gjitha shtëpitë ... për bindje apo për oportunitizëm, duke krijuar një zhurmë shurdhuese, ndërkohë që tymi shtrinte një perde mbi gjithë qytetin.”*⁸⁶

Ky është raporti që iu dërgua Selisë së Shenjtë një muaj pasi gjermanët u larguan nga Shqipëria. Ky nuk është nga ato raportet rutinore që diplomatët përgatisin në mënyrë periodike. Cilësia e këtij raporti lidhet edhe me personalitetin e autorit të tij. Leone G. B. Nigris, përveçse diplomat, ishte një studiues skrupuloz, jo vetëm në fushën e teologjisë, po edhe për filozofi e histori. Kjo duket edhe në mënyrën si ai i regjistron e komenton detajet dhe si shkon përmes tyre në përfundime. Nigris ishte pjesëmarrës në ngjarjet dhe jo dosido: kishte informacione për komunistët dhe ushtrinë e tyre, ashtu siç kishte njohje të plotë për çdonjërin nga drejtuesit e nacionalistëve, kur kishin ardhur ata në

⁸⁵ *Po aty.*

⁸⁶ *Po aty*, p. 161.

Shkodër, ku u strehuan, kur dhe si ikën. Për më tepër, detyra ia ka kërkuar të komunikonte përditë me përfaqësitë e qytetarëve, por edhe me komandën pushtuese dhe raporti i përmban disa prej këtyre takimeve. Duket që për shkak se Nigris e njihte në hollësi gjendjen, atij ia kanë nevojën edhe britanikët, me të cilët ka komunikuar zyrtarisht dhe disa raporte të tij i kam hasur në arkivat e Londrës. Kësisoj, kur shkruajmë për Luftën e Dytë Botërore në Shqipëri ia vlen që midis gjithë dëshmimeve, t'i mbajmë si referencë të besueshme edhe dëshmitë e Nigrisit, sigurisht në një plan shumë më të gjerë nga sa m'u desh mua t'i përdorja në këtë trajtesë.

Data apo dita e Çlirimit

Pasi vajtëm tek e vërteta e largimit të gjermanëve nga Shkodra, them se në pikëpamje të përshkrimit historik tanimë pamja është më e qartë dhe, sipas meje, synimi i kësaj trajtese mund të quhet i mbërritur. Diskutimet e tjera mund të jenë të natyrave të çfarëdoshme, politike, juridike, ushtarake, fusha që nuk janë të mijat dhe që jo gjithherë ndjehem e afërt me to. Megjithatë, duke u marrë me këtë temë ka çaste që të mundojnë. Për shembull, nuk më duket se ka të keqe të diskutojmë për saktësimin e një ngjarjeje historike, cilado qoftë ajo, po kur orientimet vijnë si nevojë politike e pushtetit dhe për më tepër institucionet i nënshtrohen kësaj nevoje, atëherë ky është keqpërdorim i tyre. Kështu ndodhi më 1993 me Institutin e Historisë dhe për të ky shënohet si momenti më i vështirë që prej njëzet vjetësh. Një siklet tjetër është mënyra si njerëzit e shkencës përshtaten me interesat politikë të çastit. Nuk po u hyj të këqijave që vijnë nga rreshtimi politik i njerëzve të shkencës, pasi tanimë çdokush prej nesh ka pasur rast të vërejë sa selektivë kthehen këta njerëz në përzgjedhje dhe sa të njëanshëm në interpretime. Kjo dukuri vlen edhe për temën në fjalë.

Por ajo që ka rënë më shumë në sy është fshehja e qëllimit, çka në një farë mënyre ky është manipulim me ngjarjen. Në përgjithësi, së paku në shkrimet e historianëve, por edhe të politikanëve, ajo që sipas rastit është sulmuar ose është mbrojtur me të njëjtin pasion është *Data* dhe jo *Dita* e çlirimit. Në përgjithësi, të gjithë ata që janë marrë me temën, kanë hyrë në hollësira rreth datës dhe janë rrekur të argumentojnë njërin ose tjetrin version. Por të merresh thjesht me datën dhe me qëllim saktësimin e saj, kjo nuk përlligj kurrfarë pasioni, me të cilin mbron ose kundërshton. Është bërë prej kohësh e dukshme se problemi që në krye ka qenë më i

thellë, që do të thotë se problemi nuk është *data*, po *dita*. Pra, problemi është *simboli*. Atëherë një palë u ngrit për të rrëzuar simbolin dhe një palë për ta mbrojtur. Të parët nuk e artikuluan asnjëherë qëllimin, të dytët e kanë denoncuar, por argumentet kanë qenë të varfra.

Ndër njerëzit e letrave, ndoshta i pari, që iu largua një hileje të vjetër dhe foli hapur është Agron Tufa. Në një punim të tij për simbolikën e komunikimit politik, ai thotë: *“Të majtët shqiptarë, ndër shumë ekuivokë në lidhje me trashëgiminë e tyre ideologjike, kapen pas mitit të 29 nëntorit si kryesimboli i festës së tyre kalendarike, kësaj stërgjysheje ilegjitime që ka pjellë të gjitha simbolet e tjera më të vogla. Nëse do të binte ky kryesimbol, do të çahet e gjithë piramida e simboleve të tjera. Rëndësi ka simboli, miti, rituali, inicimi që diktojnë sjelljen dhe orientojnë energjitë. Pak rëndësi ka cila është e vërteta. Zaten në politikë dhe në ideologji e vërtetë është vetëm ajo që i shërben kauzës. Është pikërisht ky thelb simbolik që modelon ndjeshmërinë dhe tipin e ligjëritimit në komunikimin politiko-ideologjik.”*⁸⁷ Autori bën një rekomandim të sinqertë për mënyrën si mund të çahet piramida e simboleve dhe për këtë ai i mbahet një kriteri, që është kriteri politik. Ai vetë e thotë: *“në politikë dhe në ideologji e vërtetë është vetëm ajo që i shërben kauzës”*. Rekomandimi mbase do respektuar, por gjithnjë brenda kriterit politik të simbolikës dhe jo jashtë tij. Kriteri politik nuk do të thotë se është edhe kriter historik. Ato nuk janë e njëjta gjë dhe jo gjithnjë të përputhshme.

E vërteta është se tek ne kriteri historik ka shërbyer gjatë si nënshartesë për kriterin politik. Që do të thotë se ngjarjet historike pa përjashtim janë përdorur në pajtim me nevojat politike të pushtetit, madje jo pak prej tyre edhe janë modeluar sipas këtyre nevojave. Të kuptohemi, në të gjitha kohët çdo popull ka ndërtuar vetëdijen e vet historike dhe është normale që historia e shkruar t'i shërbejë kësaj vetëdijeje. E papranueshme është që historia të shkruhet e përdoret për interesat e pushteteve. Kësisoj, nëse në këtë kohë postkomuniste, do të ishte e nevojshme rrëzimi i simbolikave komuniste, kjo duhet bërë hapur dhe pa ekuivokë. Por kjo nuk është punë e historianëve. Me këtë sy mendoj se duhet parë edhe 29 nëntori. Po më parë duhet sqaruar a është kjo ditë simbol i komunistëve? Afër mendsh që partia komuniste do ta përdorte si aset të saj, por mendoj se përfshirja dhe kontributi i njerëzve të thjeshtë

⁸⁷ Agron Tufa, “Simbolika e komunikimit politik”, Gazeta *Panorama*, nr.2595, 28 dhjetor 2009.

në luftë shkon edhe më përtej rolit të një partie, qoftë edhe duke u shfaqur ajo forcë kryesore e organizimit të rezistencës. Pa folur që, sidomos në një periudhë të luftës, pa filluar përplasja e brendshme, roli i nacionalistëve është i vlerësueshëm. Sidoqoftë, nuk dua të shtyhem më tej në këtë pikë. Nëse 29 nëntori, jo si datë, po si ditë, është simbol komunist, ky është vlerësim që i përket politikës dhe është ajo që e rrëzon ose e mban. Ajo çfarë kemi parë deri më tani është se asnjë krah politik nuk ka guxuar ta bëjë këtë, madje as ballistët. Pikërisht për shkak të kësaj mungese guximi, apo për kalkulime llogarish, është gjetur rruga tinëzore e një vendstrehimi të ri për ditën simbol. Kjo është arsyeja e pasionit “shkencor” me të cilën është mbrojtur ndryshimi i simbolit, po që do të nxiste natyrshëm edhe pasione kundër.


Duket pra se politika është ndarë jo për datën, po për ditën e çlirimit. E para, pra data, është kategori kohore, bën të dallueshme një ditë nga një tjetër, duke regjistruar brenda saj edhe të dhënat përkatëse të dukurive natyrore, ngjarje shoqërore, politike etj. Në varësi të ngjarjeve, peshës që ato kanë, ndodh që data të caktuara kthehen në përfaqësuese, deri edhe ditë-simbol për grupime shoqërore, për një vend ose një tjetër, për popuj ose grupe popujsh. Kështu është edhe 29 nëntori ynë, të cilin disa e lexojnë si dita e fitores në Luftën Antifashiste të popullit shqiptar, disa e lexojnë si dita e instalimit të shtetit komunist, e instalimit të dhunës etj. Këta të dytët, domethënë këta që e lexojnë si ditë të instalimit të diktaturës, pranojnë 28-ën si ditë fitoreje, por jo të nesërmen, sepse ajo gjoja ndryshuaka (!). Me fjalë të tjera, nuk qenkësh njësoj nëse Shqipëria është çliruar më 28 dhe nëse më 29! Po çfarë ka të veçantë 28-a? Dihet se më 28 nëntor 1944 në Tiranë, në kryeqytet, hyri qeveria komuniste me kryeministër Enver Hoxhën. Të gjitha tekstet e historisë këtë kanë informacion të parë për atë ditë. Sigurisht ngritja e strukturës së pushtetit komunist nuk i përket vetëm një dite, ajo ka filluar më përpara, së paku që në Përmet, më 24 maj, por midis të gjitha ditëve nuk ka tjetër ditë simbol të instalimit të komunizmit më shumë se dita kur Enver Hoxha zbriti nga malet dhe marshoi në Tiranë. Le të pranojmë, ka diçka që nuk shkon. Por, sidoqoftë, këto janë komente politike. Ajo që mendova të trajtoj është vetëm çfarë ka ndodhur në Shkodër ato pak orë të para dhe pasmesnatës së 28 nëntorit, deri në të gdhirë, më 29 nëntor.

Nëntor 2014

S u m m a r y

DILEMMA OF LIBERATION

In the study "Dilemma of Liberation" is analyzed liberation day as accurate historical time and as a symbol. The day or the date of liberation has sparked much debate and also there has had much speculation over it during these past 20 years. I have commented the known documents and I have brought a series of Albanian, German and Italian unknown documents until now. In this article I deal more with scientific methodology and typology for the study of this event, for example, the criterion for determining the celebration day, which is the liberation of the latter city; the spirit as well as the details that the documents bring; the liberation day as a problem not only historical and political but also legal one; the difference between the day and date of the liberation. I explain circumstances in which the city of Shkodra was liberated, when it was surrounded by partisans' brigades, who made impossible for units of the German army stay in the city and forced them to leave SHkodra as soon as possible at night of 28th-29th November.



pani i u kërcënuen atyne se do t'u bijshin mbas shpinde nëse zbrasëshin goftë edhe një plumb të vetëm kundër dshtrisë okupatore. Atëherë nuk dojshin gjoja me luftue në qytet pse merreshin në qafë populli.

P o s o t !

Ata bashkë me Halil Alin e Mato Muratin formuen Komitetin e tyne të trathëtisë sepse Gestapoja gjermane e dinte se ka kalue kohe e dallaveret me Salih Myftin, Hafis Ali Tarin, Shaqir Amarin e tjerë krenë të Ballit e të Legalitetit. Okupatori kishte besim vetëm ndër njerzë si Gjon Marka Gjoni, Sylço Bushatin, Halil Alija, Kolë Biba, Mato Murati, Enver Bushati që janë deklarue anmiqë të hapët të popullit e që mendojshin bashkë me okupatorin me e ba shesh lufte Shkodrën. Kurse kriminel-hajdut Hasan Isufi mundoheshe me i a mbushë mëndjen popullit se gjoja asht kundra Gjon Marka Gjoni e nga ana tjetër ay ishte komandant në shërbimin e tij dhe t'okupatorit.

Të gjithë këta tradhëtar deshtën me e habitë pupullin se gjoja Gjarmanët janë në të çuem e prandej pse të damtohemi. Por neve e dijmë se Ushtria gjermane nuk do të loste nga Shkodra sikur mos të kishte frikën e partizanëve dhe sikur këta mos t'a zbojshin me forcën e armëve. Gjithashtu pepulli nuk u a vari torbën këtyne pallavravet, por përkundrazi u organizue ndër njisite partizane për t'i kumbinue veprimet me ato të partizanvet të malit.

Këjo dëshmon se sa e ka urrejtë populli i qarkut t'onë akupatorin e trdhëtarët. Dhe këjo na len me shpresue se populli i jonë nuk do t'i uli armët derisa mos t'a qërojë vendin nga çdo gjurmë nazisti barbarë e tradhëtarësh, të cilëvet u vjen festja vërdallë sepse nuk dijnë se nga t'i a mbajnë. Ka shumë ditë që për ata ndëgjohet era hallvë të vdekuni, kurse për popullin t'onë qeshte Dielli i Lirisë.

Shkodra kreshnike në këto çaste vendimtare ka për të dijtë me e ditue vehten. Gjaku i Vasos, Perlatit, Brankos, Esatit, Vasilit, Manushit e tjerëvevet lypë çpagim. Dëshmorët që nga varret thrasin hakmarrje.

Prandej puntorët, katundarët, qytetarët e Rinija e Shkodrës bashkë me partizanët do t'a dlinin krahinën t'onë nga të gjithë tradhëtarët që për kaq vjetë me ralhë i pinë gjakun popullit e Rinisë s'onë heroike.

Në këtë ditë të festës s'onë Kombtare një za duhet të buçasi nga të gjitha anët:

Përpara, gjithnji përpara që të fitojmë e të hakmerremi !

KOMITETI QARKOR PËR SHKODRËN

I PARTIS KOMUNISTE SHQIPTARE

28 Nandor 1944.

SHKODRA U ÇLIRUA

NË SHQIPËRI S'LBETI MË KËMBI OKUPATORI DHE TRATHTARI

Shqipëria plotësoi çlirimin e saj. Shkodra, që këta muajt e fundit ishte bërë fortesa e okupatorit nacist dhe që në tepër foletë e politikanëve hajdutë të reaksionit Shqiptar, u çlirua nga forcat e Ushtrisë s'onë heroike. Atje lart, mbi Taraboshin historik valon flamuri i lirisë, i luter me gjakun e partizanëve trimë.

Populli Shqiptar, mbasi tri vjet luftë të përgjakshme dhe sakrificash të jashtzakonshme, mbasi u dëq e u poq në këtë luftë vigane kundër ordhëve fashist-naoiste dhe mercenarëve të tyre, në sajë të Ushtrisë së tij dhe të politikës së drejtë të Frontit Nacional-Çlirimtar realizoi ëndërrën e tij dhe amanetin që i lanë dëshmorët e rënë në këtë luftë të shënjtë. Populli Shqiptar me gjakun e derdhur rëkë e spastroi gjithë Shqipërinë nga armiqët e saj të jashtëm dhe të brendshëm, s'mboti më asnjë ushtar gjerman, asnjë mercenar ballist ose zogist në Shqipëri.

Dhe tashti? Dëshmorët e rënë në sheshin e luftës na kanë lënë edhe një amanet tjetër, testamentin e ndërtimit të Shqipërisë së re, po me ato sakrificë, po me ato heroizma, po me atë entuziazëm me të cilat vazhduam luftën e madhe për liri. Përpjekjet gjigante të popullit t'onë kishin dhe kanë një përmbajtje politike dhe ushtarake të caktuar. Nëpërmjet të luftës kundër okupatorit dhe trathëtarëve të ndërtohej skeleti i pushtetit të tij popullor dhe ky skelet u ndërtua në Kongresin Antifashist të Përmetit, i cili i dha popullit kompleksin e fuqisë së tij legislative dhe ekzekutive. Zgjedhja e Qeverisë Demokratike në Berat është një hap përpara drejt realizimit të ëndërrave të popullit t'onë.

Tani që me çlirimin e Shkodrës historike plotësohet spastrimi i vëndit t'onë nga xhelatët e brendshëm dhe të jashtëm, tani që armiku u thye dhe u shpartallua ushtarakisht, na mbetet të vazhdojmë rrugën e idealit të dëshmorëve t'onë, për të cilin ranë në fushën e nderit, rrugën e përforcimit dhe të perfeksionimit të pushtetit t'onë popullor.

I vetmi thesar që fitoi populli i ynë nga kjo përleshje e madhe është pushteti i tij. Me anë të këtij aparati do të ndërtohet Shqipëria e re, ku me punën dhe me djersën t'onë do t'arrimë shkallë-shkallë në një jetë gjithënjë më të mirë dhe më të lumtur.

Këshillat Nacional-Çlirimtare janë pushteti i ynë popullor, janë organet që i japin popullit të gjitha mundësitë për zhvillimin e tij politik, ekonomik, kulturor dhe administrativ. Kjo është esenca e demokracisë s'onë, këtu përshtetet deklarata e Këshillit Antifashist të Shqipërisë mbi të drejtat e qytetarit.

Pra, zgjedhjet për Këshillat Nacional-Çlirimtare, tani me çlirimin e plotë të vëndit t'onë, marrin një rëndësi të jashtzakonshme, jo vetëm pse ato pullin në punë për ndërtimin e një Shqipërie të typit të ri, ku punëtori, fshatari, zanatçiu, intelektual i etj. të gjejnë punë dhe një përmirësim gradual në jetën e tyre.

Prandaj duhet të mendojmë përpara se të japim votën, prandaj duhet të zgjedhim punëtorë energjikë dhe me koshiençë në Këshillat Nacional-Çlirimtare. Fjala e jonë e fundit është të zgjedhim në Këshilla ata që e meritojnë atë vënd, si vazhdë e idealeve të dëshmorëve t'onë, ata që punojnë dhe do të punojnë në farrën e ndërtimit të vëndit t'onë.

RRROFTË SHKODRA E ÇLIRUAR.

RRROFTË PUSHTETI I YNË POPULLOR.

RRROFTË SHQIPËRIJA E LIRË, PA NACISTA, PA BALLISTA, PA ZOGISTA DHE PA MERCENARË.

RRROFTË USHTËRIJA NACIONAL-ÇLIRIMTARE DHE KOMANDANTI I SAJ GJENERAL-KOLONEL ENVER HOXHA.

30/XI/1944

-----*o*-----